



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.1

26 janar 2004

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM
nr.1, datë 7.1.2004

Për miratimin e Kontratës së lidhur, ndërmjet Ministrisë së
Financave dhe Raiffeisen Zentralbank, Austri, për shitjen 100
për qind të aksioneve të Bankës së Kursimeve sh.a.....

3

Vendim i KM
nr.7, datë 14.1.2004

Për miratimin e protokollit të bisedimeve, ndërmjet Këshillit të
Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së
Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin
financiar dhe teknik për vitin 2003.....

27

VENDIM
Nr.1, datë 7.1.2004

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË
FINANCIVE DHE RAIFFEISEN ZENTRALBANK, AUSTRI, PËR SHITJEN
100 PËR QIND TË AKSIONEVE TË BANKËS SË KURSIMEVE SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të seksionit "X" të vendimit nr.452, datë 28.6.2001 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e procedurës së privatizimit dhe të termave të kontratës së shitjes së aksioneve të Bankës së Kursimeve sh.a.", ndryshuar me vendimin nr.630, datë 18.9.2003 të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Raiffeisen Zentral bank, Austri, për shitjen 100 për qind të aksioneve të Bankës së Kursimeve sh.a., me vlerë 18 000 (tetëmbëdhjetë mijë) USD për aksion dhe me vlerë të përgjithshme 126 000 000 (njëqind e njëzet e gjashtë milionë) USD, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ministri i Drejtësisë të shprehë opinionin ligjor, siç është përcaktuar në Kontratën e shitjes së aksioneve të kësaj Banke.

3. Ministria e Financave merr përsipër të gjitha detyrimet që do të lindin si rezultat i konflikteve për marrëdhëniet e punës me punonjësit dhe ish-punonjësit e Bankës së Kursimeve sh.a., përpara datës së hyrjes në fuqi të Kontratës së shitjes së aksioneve.

4. Ngarkohet Ministri i Financave të nënshkruajë këtë Kontratë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

KONTRATË PËR SHITJE AKSIONESH

Kjo Kontratë lidhet sot më datë janar 2004, ndërmjet

1) Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministri i Financave, i cili vepron për llogari të shtetit shqiptar si aksioner i vetëm i aksioneve të Bankës së Kursimeve të Shqipërisë ("Shitësi")

dhe

2) Raiffeisen Zentralbank Österreich Aktiengesellschaft, shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Austrisë me seli në Am Stadtpark 9 A-1030 Vjenë, Austri, përfaqësuar nga z.Jeffrey Millikan me prokurën e datës 9 janar 2004 ("Blerësi").

HYRJE

A. Banka e Kursimeve e Shqipërisë është regjistruar si person juridik, sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, më datë 11 dhjetor 1992, në përputhje me ligjin nr.7560, datë 28.4.1992 dhe është regjistruar si shoqëri anonime në regjistrin tregtar të Gjykatës së Rrethit të Tiranës, me vendim gjykate nr.17426 i datës 10 korrik 1997, me seli në rrugën "Dëshmorët e 4 Shkurtit" nr.6, Tiranë ("Banka"). Kapitali i regjistruar i Bankës është 700 milionë lekë, përbërë nga 7000 aksione të zakonshme me vlerë nominale 100 000 lekë secili.

B. Shitësi është pronari i regjistruar i të gjithë kapitalit të regjistruar të Bankës.

C. Në përputhje me ligjin nr.8563, datë 22 dhjetor 1999 "Për përcaktimin e formës dhe mënyrës së privatizimit të Bankës së Kursimeve të Shqipërisë", (me ndryshimet) dhe vendimeve nr.452 dhe nr.630 të Këshillit të Ministrave, respektivisht të datave 28 qershor 2001 dhe 18 shtator 2003, Shitësi ofron për shitje 35 deri në 100 për qind të kapitalit të regjistruar të Bankës me tender të hapur ndërkombëtar.

D. Më 23 shtator 2003, nëpërmjet njoftimeve të publikuara, Shitësi ftoi personat e interesuar të shprehin interesin për të blerë në Bankë një numër strategjik aksionesh të Bankës.

E. Më 25 tetor 2003, Shitësi shpalli Blerësin si investitor strategjik të parakualifikuar dhe e ftoi atë të merrte pjesë në tender.

F. Nga data 10 nëntor deri më 21 nëntor 2003, Blerësi vizitoi dhomën që përmbante informacion financiar, ligjor, tregtar dhe operativ rreth Bankës dhe kreu analizën e vet të pavarur për gjendjen e Bankës.

G. Blerësi i dorëzoi Shitësit një ofertë detyruese më datë 17 dhjetor 2003.

H. Më 20 dhjetor 2003, Këshilli i Ministrave miratoi Blerësin si ofertuesin fitues me vendimin e Komisionit të vlerësimit të ofertave, duke shpallur fitues Blerësin.

L. Shitësi ka rënë dakord të shesë dhe Blerësi ka rënë dakord të blejë 7000 aksione, aksione të Bankës që përfaqësojnë 100 për qind të kapitalit të regjistruar sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Kontratë.

J. Para lidhjes së kësaj Kontrate, palët lidhin Marrëveshjen Escrow me Bankën Escrow që tregohet në shtojcën A, bashkëngjitur.

Tani, në vijim, palët bien dakord si më poshtë:

1. PËRKUFIZIME

Për zbatimin e kësaj Kontrate, fjalët ose shprehjet e përmendura më poshtë do të kenë kuptimet që do t'u jepen si më poshtë:

"Kontratë" do të thotë kjo Kontratë shitjeje aksionesh, së bashku me të gjitha shtojcat dhe afatet bashkëngjitur asaj, të ndryshuara ose të plotësuara hera-herës.

"Autoriteti shqiptar i konkurrencës" do të thotë komisioni i konkurrencës, që përcaktohet në nenin 19 të ligjit nr.9121 të datës 28 korrik 2003.

"ALL" do të thotë lekë shqiptarë, monedha zyrtare në Republikën e Shqipërisë.

"Ligji bankar austriak" do të thotë ligji bankar austriak i vitit 1993, i ndryshuar së fundmi nga BGBl. 1 Nr.80/2003.

"Ligj bankar" do të thotë ligji nr.8365, datë 2 korrik 1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

"Banka e Shqipërisë" do të thotë Banka Qendrore e Shqipërisë, e cila, ndër të tjera, licencon bankat e nivelit të dytë dhe mbikëqyr të gjitha veprimtaritë bankare në territorin e Republikës së Shqipërisë.

"Transferimi i huave Agjencisë së Trajtimit të Kredive" do të thotë huatë, të cilat i janë transferuar Agjencisë së Trajtimit të Kredive sipas urdhrit me numër protokolli 755 i datës 6 shkurt 2001 dhe me numër protokolli 755/1 i datës 15 shkurt 2001 dhe me numër protokolli 3799 i datës 1 qershor 2002 të Ministrit të Financave, lëshuar në zbatim të ligjit nr.8339 i datës 30 prill 1998, ndryshuar me ligjin nr.8584 i datës 15 mars 2000.

"Ditë-pune" do të thotë ditë në të cilën bankat janë të hapura për punë në Austri, shtetin New York dhe në Republikën e Shqipërisë.

"Kushtet paraprake" do të thotë kushtet paraprake të përcaktuara në paragrafin 4.

"Marrëveshja e konfidencialitetit" do të thotë Marrëveshja e konfidencialitetit, e lidhur më 27 tetor 2003 ndërmjet Blerësit, Shitësit dhe Bankës.

"Kontrolli", kur ka të bëjë me person, do të thotë zotërimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i tagrës për të drejtuar ose detyruar drejtimin e përgjithshëm të menaxhimit dhe politikave të këtij personi, si nëpërmjet zotërimit të më shumë se 50 % (për qind) të aksioneve me të drejtë vote, ose nëpërmjet interesave të ortakërisë (ose instrumenteve të barasvlefshme me to), me anë kontrate, ose në ndonjë mënyrë tjetër.

"Barrë" do të thotë çdo hipotekë, kolateral, peng, kosto, kufizim, sekuestrim, mundësi, e drejta e parablerjes, e drejta e zgjedhjes së parë ose çdo barrë tjetër, e çfarëdo natyre qoftë.

"Llogari Escrow" do të thotë depozitë që prodhon interesa të përcaktuar në USD si llogari depozite, që do të hapet në Bankën e llogarisë së ngurtësuar si garanci në emër të Blerësit dhe Shitësit.

"Marrëveshje e Llogarisë Escrow" do të thotë Marrëveshje për Llogari Escrow midis Shitësit, Blerësit dhe Bankës së Llogarisë Escrow në formën bashkëngjitur këtu në shtojcën A.

"Banka e Llogarisë Escrow" do të thotë Banka American Express LTD, një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të shtetit të Konektikatit, SHBA, me seli qendrore dhe agjenci në New York, në 200 Vesey Street, kati 22, New York, New York 10285 SHBA.

"Faza e parë" do të thotë përmbushja e veprimeve të përcaktuara në paragrafin 5.4.

"IAS" do të thotë standarde ndërkombëtare të kontabilitetit.

"IAS llogari 6-mujore të kontrolluara" do të thotë llogaritë e përvizionuara të Bankës, të përgatitura në përputhje me IAS për 6 muaj, që mbarojnë më datë 30 qershor 2003, përfshirë bilancin e Bankës të datës 30 qershor 2003, deklarimin e operacioneve, deklarimin e ndryshimeve në mënyrë të paanshme dhe deklarimet e likuiditetit të llogarisë rrjedhëse të Bankës, lidhur me periudhën 6 (gjashtë) mujore së bashku me shënimet përkatëse, të përgatitura nga Banka dhe të rishikuara nga Deloitte and Touche sh.p.k., auditorë publikë të pavarur (përfshirë raportin e auditimit të ekspertëve kontabël të pavarur të datës 16 tetor 2003, të cilin Deloitte and Touche sh.p.k., ia ka dhënë aksionerit dhe drejtuesve të Bankës), siç përcaktohet në shtojcën E bashkëngjitur.

"Ndryshim thelbësor me pasoja negative" do të thotë secila prej ngjarjeve të mëposhtme:

a) vendim i marrë nga Banka e Shqipërisë për tërheqjen, shfuqizimin ose pezullimin e lejes bankare të Bankës;

b) vendim i formës së prerë i një gjykate kompetente, që e shpall Bankën në pamundësi pagese ose falimentimi;

c) fillimi nga vetë Banka i procedurave të likuidimit të saj;

d) çdo ngjarje ose një seri ngjarjesh, të cilat dalin si rezultat i menaxhimit ose operacioneve të Bankës (por duke përjashtuar ndonjë pagesë të dividendit apo shpërndarje tjetër), që veç ose bashkërisht kanë shkaktuar rënien e kapitalit aksioner të Bankës nën 3 000 000 000 (miliardë) lekë.

"Çmimi i shitjes" ka kuptimin e dhënë në paragrafin 3.

"Aksionet në shitje" do të thotë 7000 (mijë) aksione të Bankës që përfaqësojnë 100% (një qind për qind) të kapitalit të regjistruar që do të transferohet nga Shitësi tek Blerësi sipas kësaj Kontrate.

"Faza e dytë" do të thotë përmbushja e veprimeve të përcaktuara në paragrafët 6.2 dhe 6.3.

"Personi i kontrolluar" do të thotë çdo person ose persona mbi të cilët Banka ka kontroll.

Në këtë Kontratë, në rast se nuk del qëllimi i kundërt, referimi në një paragraf ose shtojcë është referim në një paragraf ose shtojcë të kësaj Kontrate. Shtojcat janë pjesë e pandashme e kësaj Kontrate.

2. SHITBLERJA E AKSIONEVE NË SHITJE

2.1 Në përputhje me kushtet dhe në varësi të kushteve të përcaktuara në këtë Kontratë, Shitësi vendos t'i shesë Blerësit dhe Blerësi vendos të blejë nga Shitësi aksionet për shitje.

2.2 Dispozitat e kësaj kontrate (përveç paragrafëve 5 dhe 6) do të prodhojnë efekte ligjore në datën e nënshkrimit të saj nga të dyja palët. Dispozitat në paragrafët 5 dhe 6 do të hyjnë në fuqi ligjërisht në datën e përmbushjes së kushtit paraprak të përcaktuar në paragrafin 4.1.1.

3. ÇMIMI I SHITJES

3.1 Çmimi i shitjes për aksionet ("çmimi i shitjes") për shitje është në 126 000 000 dollarë amerikanë (njëqind e njëzet e gjashtë milionë), çka do të thotë 18 000 (tetëmbëdhjetë mijë) dollarë amerikanë për çdo aksion në shitje.

3.2 Çmimi i shitjes do t'i paguhet Shitësit nga Blerësi si vijon:

3.2.1 Brenda 3 (tre) ditë-pune nga data e lidhjes së kësaj Kontrate, Blerësi do të transferojë 10% (dhjetë për qind) të çmimit të shitjes në Llogarinë Escrow ("Depozita");

3.2.2 Shuma e mbetur prej 90% (nëntëdhjetë për qind) e çmimit të shitjes do të paguhet në datën e mbylljes së fazës së parë dhe mbylljes së fazës së dytë në përputhje me paragrafët 5 dhe 6 më poshtë.

3.3 Nëse kjo Kontratë zgjidhet, Depozita do të trajtohet si në vijim:

3.3.1 Nëse kushtet paraprake të përcaktuara në paragrafin 4 nuk përmbushen deri më 8 korrik 2004 (ose në një datë të mëvonshme të përcaktuar nga palët), për shkak të shkeljes nga ana e Blerësit të detyrimeve të tij sipas paragrafit 4.3, ose në një mënyrë tjetër nuk ka bërë përpjekje të mjaftueshme për të marrë miratimet nga organi rregullator, siç përcaktohet në paragrafin 4.1.2, ose Shitësi zgjidh këtë Kontratë në përputhje me paragrafin 11.1.3, atëherë Shitësi mund ta mbajë Depozitën si ndëshkim kontraktor dhe

3.3.2 në të gjitha rrethanat e tjera, depozita i kthehet Blerësit brenda 10 (dhjetë) ditë-pune nga zgjidhja e kësaj Kontrate.

3.4 Blerësi do të paguajë çmimin e shitjes pa zbritje, shlyerje ose mbajtje çfarëdo.

4. KUSHTET PARAPRAKE

4.1 Detyrimet e palëve për kryerjen e shitjes dhe blerjes së aksioneve në shitje varen nga përmbushja e secilit prej kushteve të mëposhtme:

4.1.1 Dhënia nga Banka e Shqipërisë e një vendimi administrativ përfundimtar, ligjërisht të detyrueshëm, që miraton blerjen nga Blerësi të aksioneve në shitje mbi bazën e neneve 11.3 dhe 13.2 germa (d) të ligjit bankar.

4.1.2 Dhënia nga Autoriteti Austriak i Tregut Financiar ("Finanzmarktaufsicht") e një vendimi të formës së prerë, ligjërisht të detyrueshëm, që miraton blerjen e aksioneve në shitje nga Blerësi, mbi bazën e dispozitave të nenit 21 paragrafi 1 nënparagrafi 2 të legjislacionit bankar austriak.

4.1.3 Miratimi i deklaratave financiare të bankës për vitin financiar që përfundon më 31 dhjetor 2003 nga Këshilli Drejtues i Bankës dhe Shitësi (si aksioner i vetëm i Bankës) dhe një dividend me vlerë deri në 3 000 000 000 (tre miliardë) lekë është deklaruar nga banka dhe i është paguar Shitësit.

4.2 Blerësi dhe Shitësi do të bëjnë përpjekjet e tyre të arsyeshme për të siguruar (për aq kohë që secila palë të jetë e aftë të sigurojë) zbatimin e kushteve paraprake në datën më të afërt të mundshme pas nënshkrimit të kësaj Kontrate.

4.3 Blerësi nëpërmjet këtij dokumenti merr përsipër të përgatisë dhe të depozitojë formularët për të kërkuar miratimin e blerjes së aksioneve në shitje nga Blerësi prej Autoritetit Austriak të Tregut Financiar ("Finanzmarktaufsicht") brenda njëzet ditë-pune nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate ose ku ligji i zbatueshëm përcakton një datë më të hershme për depozitimin e një kërkesë të tillë, brenda periudhës kohore të përcaktuar nga ligji i zbatueshëm. Këto kërkesa do të jenë të plota dhe të sakta sipas dijenisë së Blerësit, në përputhje me ligjin e zbatueshëm dhe, përveç kësaj, me ligjin e zbatueshëm në kohën e depozitimit. Shitësi do të bashkëpunojë me Blerësin dhe do të sigurojë të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me Shitësin ose me Bankën, siç kërkohet ligjërisht nga Blerësi për të përgatitur dhe depozituar këto kërkesa ose ndonjë informacion shtesë që lidhet me Shitësin ose me Bankën, të cilat mund të kërkohen nga autoritetet e mësipërme pas depozitimit të këtyre kërkesave. Nëpërmjet një kërkesë me shkrim, Blerësi i jep Shitësit një kopje të kërkesës. Blerësi bie dakord të mbajë të informuar Shitësin për ecurinë e kërkesave të tilla pas depozitimit të tyre dhe i jep Shitësit një kopje të të gjitha kërkesave, deklaratave ose vendimeve të dhëna nga Autoriteti Austriak i Tregut Financiar ("Finanzmarktaufsicht"). Shitësi do të përgatisë dhe do të depozitojë një formular ose do të bëjë të mundur që Banka të përgatisë dhe të depozitojë një formular që kërkon miratimin e blerjes së aksioneve për shitje nga Blerësi prej Bankës së

Shqipërisë brenda njëzet ditë-pune nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, ose aty ku ligji i zbatueshëm përcakton një datë më të hershme për depozitimin e një kërkesë të tillë, brenda afatit të përcaktuar nga ligji i zbatueshëm. Shitësi do të bashkëpunojë me Blerësin (sipas rastit) dhe do të sigurojë të gjithë informacionin që kërkon ligji në lidhje me Shitësin ose me Bankën (sipas rastit) ligjërisht nga Blerësi për të përgatitur dhe për t'i depozituar këto kërkesa ose ndonjë informacion shtesë që lidhet me Shitësin ose me Bankën, të cilat mund të kërkojnë nga autoritetet e mësipërme pas depozitimit të këtyre kërkesave.

4.4 Palët do të kryejnë një vlerësim ligjor dhe do të këshillohen me njëra-tjetrën për të vendosur nëse kërkohej ligjërisht të bëhet kërkesë pranë autoritetit shqiptar të konkurrencës dhe, nëse kjo është e mundur praktikisht sipas ligjit shqiptar, duke marrë në konsideratë statusin e krijimit të autoritetit shqiptar të konkurrencës. Shitësi vendos në bindjen e tij (pasi të këshillohet me Blerësin) nëse palët do ta kryejnë këtë depozitim. Për të shmangur çdo dyshim, dispozitat e paragrafit 3.3.1 dhe 4.3 nuk do të zbatohen në rast se Blerësi vendos të kryejë depozitimin tek autoriteti shqiptar i konkurrencës.

5. FAZA E PARË E SHITJES SË AKSIONEVE NË SHITJE

5.1 Faza e parë e shitjes dhe blerjes së aksioneve në shitje duhet të mbyllet në ditën e tretë të punës pas përmbushjes së kushteve paraprake ose në një datë të caktuar nga palët me marrëveshje. Shitja e parë do të bëhet në selinë e Shitësit ose në një tjetër vend të caktuar nga palët.

5.2 Në mbyllje të fazës së parë të shitjes, Shitësi do t'i japë Blerësit mendimin e Ministrit shqiptar të Drejtësisë, duke konfirmuar autoritetin e Shitësit për të lidhur këtë Kontratë dhe për të përmbushur detyrimet e saj.

5.3 Në datën e mbylljes së fazës së parë të shitjes, Blerësi do t'i dorëzojë Shitësit dokumentet e mëposhtme:

5.3.1 një opinion ligjor, lëshuar nga avokati i brendshëm ligjor i Blerësit, dhe një opinion ligjor lëshuar nga Studio Legale Tonucci në një model të përshtatshëm për Shitësin, në të cilën konfirmohen tagrat e Blerësit për të lidhur këtë Kontratë dhe për të përmbushur detyrimet që burojnë prej saj;

5.3.2 një ekstrakt nga regjistri tregtar lidhur me Blerësin, lëshuar brenda 10 ditë-pune para mbylljes së fazës së parë të shitjes;

5.3.3 një kopje të noterizuar të të gjitha miratimeve të marra, në përputhje me paragrafin 4.1;

5.3.4 një kopje të noterizuar të versionit të fundit të statutit të Blerësit;

5.3.5 një certifikatë të noterizuar e gjendjes së shëndoshë të Blerësit;

5.3.6 një kopje të noterizuar të lejes për kryerje veprimtarie bankare të lëshuar në vendin e tij të regjistrimit;

5.3.7 një vendim të marrë nga Bordi Mbikëqyrës i Blerësit, që miraton blerjen e aksioneve për shitje.

5.4 Në datën e mbylljes së fazës së parë të shitjes, palët, me kusht që ata të kenë përmbushur detyrimet e tyre sipas paragrafit 5.2 dhe 5.3 më sipër, do të ndërmarrin veprimet sipas rendit të mëposhtëm:

5.4.1 Blerësi transferon një shumë të barabartë me 90 % të çmimit të blerjes në Llogarinë Escrow.

5.4.2 Vetëm nëse Shitësi merr një konfirmim me shkrim nga Banka e Llogarisë Escrow se shuma prej 90 % e çmimit të blerjes është transferuar në Llogarinë Escrow, në përputhje me paragrafin 5.4.1, Shitësi, si i vetmi aksioner i Bankës, do të nënshkruajë një vendim me shkrim, që miraton transferimin e aksioneve të shitjes në favor të Blerësit; dhe

5.4.3 Shitësi dhe Blerësi përgatisin një kërkesë për Gjykatën e Rrethit Tiranë për transferimin e aksioneve të shitjes dhe e depozitojnë këtë kërkesë në ditën e mbylljes së fazës së parë të shitjes ose, nëse është e mundur, në ditën pasuese, kur Gjykata e Rrethit Tiranë është e hapur për këtë regjistrim.

6. MBYLLJA E FAZËS SË DYTË TË SHITJES SË AKSIONEVE

6.1 Faza e dytë e shitblerjes së aksioneve në shitje do të bëhet ditën e parë të punës, e ndjekur nga regjistrimi i Blerësit si zotërues i aksioneve në shitje në Gjykatën e Rrethit Tiranë ose në një datë tjetër, siç është rënë dakord me shkrim midis palëve.

Shitja e dytë do të bëhet në selinë e Bankës së Llogarisë Escrow ose në një vend tjetër, siç është rënë dakord midis palëve me shkrim.

6.2 Ditën e mbylljes së fazës së dytë të shitjes, Shitësi ose Blerësi do t'i dorëzojë Bankës së Llogarisë Escrow ose:

6.2.1 një kopje origjinale ose të noterizuar të vendimit të Gjykatës së Rrethit Tiranë, ku evidentohet transferimi i aksioneve të shitjes Blerësit dhe një certifikatë të aksioneve lëshuar nga Qendra Shqiptare e Regjistrimit të Aksioneve, ku evidentohet se Blerësi është regjistruar si pronar i aksioneve në shitje në Librin e Aksionerëve të Bankës, ose

6.2.2 një udhëzim me shkrim, nënshkruar nga Shitësi dhe Blerësi, ku udhëzohet Banka e Llogarisë Escrow për të kryer veprimet për fazën e dytë të shitjes.

6.3 Banka e Llogarisë Escrow, me marrjen e njërit prej dokumenteve të përmendura në paragrafin 6.2, në përputhje me kushtet e Marrëveshjes së Llogarisë Escrow, do të transferojë shumën e plotë të çmimit të shitjes, së bashku me çdo interes përkatës që përfton Shitësi.

7. DEKLARATAT DHE GARANCITË E SHITËSIT

7.1 Shitësi në këtë mënyrë pranon se Blerësi po lidh këtë kontratë në mbështetje të deklaratave dhe garancive të përmbajtura në paragrafin 7.1. Kështu Shitësi deklaron dhe i garanton Blerësit se në datën e kësaj Kontrate dhe atë të fazës së parë të shitjes se:

7.1.1 Deklaratat e paraqitura në pjesën hyrëse A janë të vërteta dhe të sakta.

7.1.2 Shitësi gëzon të drejtën, autoritetin dhe aftësinë ligjore për të lidhur këtë Kontratë dhe Kontratën për Llogarinë Escrow dhe për të përmbushur transaksionet e parashikuara në të, në përputhje me kushtet e saj dhe nënshkruesit e kësaj Kontrate dhe të Kontratës së Llogarisë Escrow janë të autorizuar për të nënshkruar këtë Kontratë dhe Kontratën për Llogarinë Escrow në emër të Shitësit.

7.1.3 Lidhja, dorëzimi dhe përmbushja e kësaj Kontrate nga Shitësi është autorizuar ligjërisht nga të gjitha veprimet e nevojshme të Shitësit dhe, përveç rastit kur ndryshe është shprehur në këtë Kontratë, nuk do të kërkojë pëlqim, heqje dorë, miratim, licencim ose autorizim të, ose ndonjë deklaram, njoftimin e depozitimit pranë një personi apo autoriteti publik, dhe se ajo nuk rezulton dhe nuk do të rezultojë në shkelje apo mosplotësim nga ndonjë marrëveshje, vendim gjykatë apo ligj, ku Blerësi është palë apo me të cilën lidhet ndonjë nga pronat e tij.

7.1.4 Kjo Kontratë përbën një detyrim të vlefshëm ligjor të Shitësit dhe është e zbatueshme ndaj Shitësit në përputhje me kushtet e saj.

7.1.5 Procesi i privatizimit të Bankës, si dhe përzgjedhja e Blerësit si ofertues fitues u krye në përputhje me ligjin nr.8563, datë 22.12.1999 (siç është ndryshuar) "Për përcaktimin e modelit dhe formës së privatizimit të Bankës së Kursimeve Shqiptare", si dhe të vendimeve nr.452 dhe nr.630 të Këshillit të Ministrave datë 28.6.2001 dhe 18.9.2003 përkatësisht.

7.1.6 Shitësi është zotëruesi i vetëm i aksioneve në shitje, i lirë nga çdo barrë, dhe është i autorizuar për të shitur dhe për t'ia transferuar aksionet në shitje Blerësit në përputhje me këtë Kontratë. Shitësi ka të drejtë të ushtrojë të gjitha të drejtat e votimit dhe të drejta të tjera që janë të lidhura me aksionet për shitje.

7.1.7 Aksionet në shitje janë emetuar ligjërisht nga Banka, ekzistojnë dhe janë paguar plotësisht. Nuk ka garanci ose instrumente të tjera të dukshme lidhur me aksionet në shitje dhe nuk ka marrëveshje për shitjen ose transferimin e këtyre aksioneve, ose për sigurimin e ndonjë aksioni të ri, ose këmbimet e ndonjë aksioni ose letra me vlerë në aksionet e Bankës.

7.1.8 Banka është themeluar dhe ekziston ligjërisht si shoqëri anonime shqiptare, me kompetenca të plota, të zotërojnë dhe/ose të përdorë aktivet e saj në kufirin dhe qëllimin për të cilat i zotëron dhe/ose i përdor momentalisht për të ushtuar veprimtarinë e saj në mënyrën dhe kufirin që e kryen momentalisht.

7.1.9 Përveç se siç është detajuar në shtojcën B, Banka nuk ka degë ose shoqëri bija, dhe nuk ka rënë në marrëveshje për t'u bërë pjesëtare e ndonjë shoqërie të përbashkët, konsorcium, ortakëri ose ndonjë personi tjetër juridik të peregjistruar.

7.1.10 Banka zotëron një licencë bankare të dhënë ligjërisht në përputhje me ligjin bankar dhe për aq sa ka dijeni Shitësi nuk ekzistojnë rrethana, të cilat do të shkaktonin revokimin, anulimin ose shkeljen e saj.

7.1.11 Përveç se siç është detajuar në shtojcën C të kësaj Kontrate, Banka zotëron një titull pronësie ligjor të pastër dhe të çliruar nga çdo lloj kufizimi për token dhe ndërtesat e radhitura në llogaritë 6-mujore të audituara sipas IAS.

7.1.12 Transaksionet që përfshijnë transferimin e huave tek Agjencia e Trajtimit të Kredive janë kryer në përputhje me të gjitha ligjet e zbatueshme dhe janë ligjërisht të vlefshme dhe të ekzekutueshme kundrejt palëve përkatëse dhe asnjë palë nuk ka të drejtë të transferojë, ose në asnjë mënyrë tjetër nuk mund t'i kalojë Bankës hua, që përfshihen në huatë e transferuara Agjencisë së Trajtimit të Kredive, pa pëlqimin e Bankës.

7.1.13 Banka ka bërë kontabilizimin e rregullt në llogaritë 6-mujore të IAS të transferimit të aktiveve tek Agjencia e Trajtimit të Kredive dhe tek Alba Post sh.a., dhe Banka do të përfitojë të gjitha të ardhurat, në lidhje me transferimin e aktiveve, të cilat shfaqen në llogaritë 6-mujore të IAS si shuma të arkëtueshme Banka.

7.1.14 Banka ka llogaritur saktë, në llogaritë 6-mujore të IAS, të gjitha taksat (duke përfshirë tatimet e prapambetura) dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar, dhe Banka ka paguar ose do të paguajë, ose do të bjerë në marrëveshje në mënyrë kronologjike para mbylljes së fazës së dytë të gjitha taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore të detyrueshme në atë kohë janë deklaruar dhe paguar, dhe asnjë prej këtyre dokumenteve ose deklaratave nuk është objekt mosmarrëveshjeje, dhe asnjë prej këtyre detyrimeve nuk do të rritet në mënyrë prapavepruese për ndonjë ngjarje të ndodhur para mbylljes së fazës së dytë të shitjes.

7.1.15 Llogaritë 6-mujore të IAS janë bërë në përputhje me IAS dhe paraqesin vlerën e vërtetë dhe të drejtë të aktiveve, detyrimeve dhe veprimtarisë financiare të Bankës deri në atë datë.

7.1.16 Me aq sa ka dijeni Shitësi, pasi ka bërë verifikimet me drejtuesit e lartë të Bankës, Banka nuk i nënshtrohet ndonjë procedure mbylljeje dhe nuk ka urdhër apo kërkesëpadi për të kërkuar likuidim, falimentim apo procedura të ngjashme në lidhje me Bankën.

7.1.17 Nga 30 qershori 2003, përse i përket Bankës:

7.1.17.1 nuk ka ndryshime thelbësore negative;

7.1.17.2 nuk ka ndodhur apo mund të ndodhë asnjë ngjarje, fakt apo çështje që mund të shkaktojë ndryshime thelbësore negative;

7.1.17.3 veprimtaria e Bankës nuk është ndikuar negativisht apo materialisht nga ndonjë faktor i pazakontë, që nuk ndikon në biznese të ngjashme në një masë të tillë dhe, me aq sa ka dijeni Shitësi, nuk ekzistojnë fakte, të cilat mund të shkaktojnë efektet e mësipërme;

7.1.17.4 veprimtaria e Bankës është ushtruar si një veprimtari tregtare në vazhdim me aktivitetin e pandërprerë dhe pa ndryshime të natyrës, objektit apo mënyrës së ushtrimit të biznesit;

7.1.17.5 Banka nuk ka ndërmarrë apo propozuar angazhime thelbësore kapitali;

7.1.17.6 Banka nuk ka deklaruar, nxjerrë apo paguar ndonjë dividend apo shpërndarje të tjera (të ndryshme nga dividendët e parashikuara në paragrafin 4.1.3);

7.1.17.7 Banka nuk ka emetuar, caktuar apo rënë dakord të emetojë apo caktojë aksione të kapitalit të regjistruara apo ndonjë letër tjetër me vlerë që mund të ngrejë një të drejtë mbi kapitalin e saj;

7.1.17.8 Banka nuk ka shpërblyer apo blerë ose rënë dakord të shpërblejë apo blejë ndonjë prej kapitalit të saj aksioner të regjistruar;

7.1.17.9 Banka nuk ka marrë hua shtesë dhe nuk ka marrë përsipër detyrime më shumë se 200 000 dollarë amerikanë për çdo operacion.

7.1.18 Informacioni i dhënë Blerësit, gjatë fazës *due diligence* është hartuar nga Shitësi me mirëbesim dhe Shitësi (mbasi ka marrë mendimin e drejtuesve të lartë të Bankës) nuk ka dijeni për ndonjë informacion që mund të ndikojë në vendimin e një Blerësi të kujdesshëm për të lidhur këtë Kontratë, i cili i është fshehur me qëllim Blerësit nga Shitësi.

7.1.19 Përveç atyre marrëveshjeve të paraqitura gjatë fazës *due diligence*, Banka nuk është palë në ndonjë marrëveshje, rregullime, premtime apo detyrime afatgjata apo të pazakonta, dhe as ka ndryshuar, as ka prishur të tilla marrëveshje, rregullime, premtime apo detyrime afatgjata.

7.1.20 Për sa kohë që Shitësi ka dijeni, pasi ka bërë verifikimet me drejtuesit kryesorë të Bankës, Banka është në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret e zbatueshme mbi të në lidhje me:

(i) pastrimin e parave dhe

(ii) mbrojtjen e të dhënave.

7.1.21 Të gjitha huatë, letrat me vlerë dhe të tjera të ardhura të bëra ose të përftuara nga Banka, që janë regjistruar në llogaritë 6-mujore të IAS përbëjnë detyrime të vlefshme të palës së detyruar në kohën e llogarive, dhe shumat e treguara si të papaguara përfaqësojnë pretendime të vlefshme ligjore të palës së detyruar në kohën e përgatitjes së llogarive, në përputhje me dokumentacionin e zbatueshëm. Dokumentacioni që evidenton të tilla hua, letra me vlerë dhe të ardhura të tjera dhe kolaterale përkatëse është i plotë dhe në zotërim të plotë të Bankës në masën e nevojshme që nevojitet për vendosjen e detyrimeve të vlefshme të palës së detyruar këtu. Shitësi nuk jep deklarata dhe garanci, lidhur me vlerën ose arkëtimin e çdo aseti ose aseteve të Bankës.

7.1.22 Shitësi nuk ka imunitet, për asnjë lloj arsye, nga ndonjë procedim, juridiksion ose përfitim i ndonjë lloji lehtësimi apo përjashtuar nga procedurat për të zbatuar forcërisht detyrimet e Shitësit në këtë Kontratë.

7.1.23 Nënshtrimi i Shitësit ndaj arbitrazhit të parashikuar në paragrafin 13.2 është i ligjshëm, i vlefshëm dhe detyrues.

7.2 Në rast se shkelet ndonjë prej deklarimeve dhe garancive të Shitësit, të dhëna në paragrafin 7.1 ose në deklaratat e Shitësit në paragrafin 9, Shitësi do të zhdëmtojë Blerësin për ndonjë dëm apo humbje të pësuar drejtpërdrejt nga Blerësi, si rezultat i shkeljeve të tilla me kusht që:

7.2.1 Përgjegjësia e përgjithshme e Shitësit për pretendime të ngritura në lidhje me shkelje të deklarimeve dhe garancive të dhëna në paragrafët 7.1.1, 7.1.5 dhe 7.1.7 deri 7.1.11, përfshirë këtë të fundit, dhe 7.1.14 deri 7.1.23, përfshirë ose në lidhje me deklaratat në paragrafin 9, nuk do të tejkalojë 50 % (për qind) të çmimit të shitjes.

7.2.2 Përgjegjësia e përgjithshme e Shitësit për pretendime të ngritura në lidhje me shkeljen e deklarimeve dhe garancive të dhëna në paragrafët 7.1.2 deri 7.1.4, përfshirë këtë të fundit, 7.1.6, 7.1.12 dhe 7.1.13, nuk do të tejkalojnë shumën e çmimit të shitjes.

7.2.3 Shitësi nuk do të jetë përgjegjës për asnjë pretendim të veçantë (ose procese për pretendime të ngritura nga fakte apo rrethana thelbësisht të ngjashme) në lidhje me shkeljet e garancisë dhe deklarimeve, në qoftë se shuma e secilit pretendim nuk tejkalon 7 000 000 lekë.

7.2.4 Shitësi nuk ka detyrime për pretendime, në qoftë se shuma e përgjithshme e të gjitha pretendimeve, të cilat tejkalojnë shumën e përcaktuar në 7.2.3 më sipër dhe janë njoftuar rregullisht sipas pikës 7.3 më poshtë, nuk kalon 27 000 000 lekë.

7.3. Shitësi nuk do të jetë përgjegjës për shkelje të ndonjë garancie, deklarimi ose premtimi, po të mos ketë marrë njoftimin me shkrim nga Shitësi për shkeljen e tyre:

7.3.1 lidhur me shkeljet e deklarimeve dhe garancive të parashikuara në paragrafët 7.1.1 dhe 7.1.5 dhe 7.1.7 deri në 7.1.11, përfshirë këtë të fundit dhe 7.1.15 deri 7.1.23, përfshirë këtë të fundit, ose në lidhje me premtimet në paragrafin 9, brenda 18 (tetëmbëdhjetë) muajve nga data e mbylljes së fazës së dytë të shitjes;

7.3.2 lidhur me shkeljet e deklarimeve dhe garancive të shprehura në paragrafët 7.1.2 deri në 7.1.4, përfshirë këtë të fundit, 7.1.6, 7.1.12 dhe 7.1.13, brenda 5 (pesë) vjetëve nga data e mbylljes së fazës së dytë të shitjes;

7.3.3 lidhur me shkeljet e deklarimeve dhe garancive të shprehura në paragrafin 7.1.14, brenda 6 (gjashtë) vjetëve nga data e mbylljes së fazës së dytë të shitjes.

7.4 Shitësi nuk do të jetë përgjegjës në lidhje me pretendimin për shkelje të garancisë, në rast se ajo lidhet me ndonjë përgjegjësi apo detyrim nga ana e Bankës:

7.4.1 i cili është parashikuar ose për të cilën pagesa ose shlyerja është reflektuar në llogaritë 6-mujore të IAS;

7.4.2 e cila ka lindur për shkak të një ndryshimi në legjislacionin e hyrë në fuqi në ose pas datës së kësaj Kontrate;

7.4.3 që ka ndodhur nga një veprim ose mosveprim nga ana e Blerësit ose e Bankës pas datës së mbylljes së fazës së dytë të shitjes ose

7.4.4 për të cilën Blerësi kishte dijeni në datën e kësaj Kontrate.

7.5 Blerësi njeh dhe pranon që në momentin e lidhjes së kësaj Kontrate nuk ka dijeni për ndonjë çështje apo fakt, i cili nuk përputhet me deklaratimet dhe garancitë të shprehura në paragrafin 7.1 apo përbën një shkelje të ndonjërit prej tyre.

8. DEKLARIMET DHE GARANCITË E BLERËSIT

8.1 Blerësi pranon se Shitësi po lidh këtë Kontratë në mbështetje të deklarimeve dhe garancive që përmbahen në paragrafin 8.1. Blerësi në këtë akt deklaron dhe Shitësit i garanton, duke filluar nga data e kësaj Kontrate dhe data e mbylljes së fazës së parë të shitjes se:

8.1.1 Blerësi është shoqëri e krijuar rregullisht dhe që ekziston në bazë të ligjislacionit të Austrisë.

8.1.2 Blerësi gëzon kompetencën dhe autoritetin e duhur, si dhe aftësinë ligjore për të lidhur këtë Kontratë dhe për të plotësuar transaksionet e parashikuara këtu, në përputhje me kushtet e saj. Edhe nënshkruesit e kësaj Kontrate, në emër të Blerësit, kanë autorizimin e duhur për të lidhur këtë Kontratë në emër të Blerësit.

8.1.3 Lidhja, dorëzimi dhe përmbushja e kësaj Kontrate nga Blerësi është autorizuar me anë të akteve të nevojshme të Blerësit dhe, përveç rasteve kur është parashikuar ndryshe në këtë Kontratë, nuk do të kërkojë pëlqimin, heqjen dorë, lejimin, licencimin, përcaktimin ose autorizimin e, ose çdo deklaram, njoftim për depozitim pranë një personi apo autoriteti publik dhe nuk rezulton dhe nuk do të rezultojë në shkelje apo mosplotësim të ndonjë marrëveshjeje, gjykimi apo ligji ku Blerësi është palë apo me të cilën lidhet ndonjë nga pronat e tij.

8.1.4 Kjo Kontratë përbën një detyrim të vlefshëm ligjor të Blerësit dhe është e zbatueshme ndaj Blerësit, në përputhje me kushtet e saj.

8.2 Blerësi deklaron se ka bërë *due diligent* e tij për biznesin dhe funksionimin e Bankës, dhe se nuk është mbështetur dhe vazhdon të mos mbështetet në ndonjë deklaratë apo garanci të Shitësit apo të ndonjë përfaqësuesi ose agjenti të tij, përveç atyre deklaratave dhe garancive që përmban kjo Kontratë.

8.3. Nëse shkelet ndonjë nga deklaratat dhe garancitë e Blerësit, të parashikuara në paragrafin 8:1, Blerësi do të kompensojë Shitësin për çdo dëm ose humbje shkaktuar Shitësit nga shkelje të tilla.

9. PREMTIMET E SHITËSIT

9.1 Shitësi i premton Blerësit se midis datës së nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe datës së mbylljes së fazës së dytë të Shitjes, ai do të sigurojë që:

9.1.1 Aktiviteti i Bankës do të kryhet në përputhje me interesat e saj të biznesit dhe në rrjedhën normale të tij nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate, konform ligjeve të zbatueshme, statutit, licencës bankare, si dhe rregulloreve të brendshme, në lidhje me të gjitha aspektet thelbësore.

9.1.2 Banka do të bëjë të gjitha përpjekjet për të ruajtur të pacenuar organizimin e biznesit të saj, klientët dhe personelin dhe (përveç në rast të miratimit me shkrim të Blerësit) nuk do të ndërmarrë veprimtari të reja biznesi, duke përfshirë, por jo kufizuar në dhënien e huave tregtare.

9.1.3 Të gjitha shumat materiale që Banka i detyrohet Qeverisë shqiptare do të jenë të paguara dhe të gjitha shumat që Qeveria shqiptare i detyrohet Bankës do të jenë të marra.

9.1.4 Blerësit do t'i jepet akses i plotë ndaj pronave, aktiveve, informacionit financiar dhe regjistrave të Bankës.

9.1.5 Banka nuk do të ndërmarrë asnjë nga veprimtaritë në vijim pa miratimin me shkrim nga Blerësi (një miratim i tillë nuk do të mbahet apo vonohet në mënyrë të paarsyeshme):

a) të ketë shpenzime kapital, që kalojnë shumën 200 000 dollarë amerikanë (dyqind mijë);

b) të tjetërsojë apo të japë ndonjë mundësi ose të drejtë për parablerje, në lidhje me ndonjë pjesë materiale të aktiveve të saj;

c) të marrë hua në para (përveçse në rutinën e biznesit) ose të bëjë ndonjë pagesë ose tërheqje në llogaritë e saj bankare (përveç pagesave rutinë);

d) të lidhë ndonjë kontratë apo të marrë përsipër ndonjë detyrim të pazakontë ose të parregullt kontrate, ose detyrim nga i cili Banka nuk mund të lirohet pa dhënë njoftim paraprak të paktën 6 (gjashtë) muaj më parë;

e) të deklarojë, të nxjerrë ose të paguajë ndonjë dividend ose shpërndarje të tjera, që tejkalojnë shumën prej 3 000 000 000 (tre miliardë) lekë;

f) të japë, të lëshojë ose të paguajë ndonjë hipotekë, kolateral, boxh ose garanci të tjera ose të japë ndonjë garanci ose dëmshpërblim, përveç atyre të rutinës së biznesit;

g) të lejojë ndonjë nga siguracionet të mbarojë ose të bëjë ndonjë veprim që do të zhvlerësonte ndonjë policë sigurimi;

h) të krijojë, të nxjerrë, të blejë ose të paguajë ndonjë klasë aksionesh apo letrash me vlerë;

i) të ndryshojë statutin;

j) të bjerë dakord në mënyrë të fshehtë ose ndryshe për të bërë ndonjë nga sa më sipër.

10. PREMTIMET E BLERËSIT

10.1 Blerësi i premtton Shitësit se për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, nga mbyllja e fazës së dytë të shitjes, ai do të vazhdojë të drejtojë të njëjtin nivel të mbulimit rajonal të rrjetit të filialeve të Bankës, siç përshkruhet në shtojcën D.

10.2 Blerësi i premtton Shitësit se ai do të vazhdojë të zotërojë mbi 50 % (pesëdhjetë për qind) të kapitalit aksioner të regjistruar të Bankës, të paktën 3 (tre) vjet nga data e mbylljes së fazës së dytë, përjashtuar rastet kur Shitësi jep pëlqimin për të kundërtën, duke siguruar që Blerësi të lejohet t'ia transferojë aksionet për shitje ndonjë personi juridik nën kontrollin e Blerësit nëse: (a) ky person juridik merr përsipër të gjitha detyrimet e Blerësit, sipas kësaj Kontrate dhe këto detyrime janë të garantuara nga Blerësi dhe (b) kur ky person juridik nuk është më në kontrollin e Blerësit për çfarëdo arsye, Blerësi do t'ia transferojë aksionet për shitje, të mbajtura nga personi juridik Blerësit ose ndonjë personi tjetër juridik nën kontrollin e Blerësit para afatit kur personi juridik del nga kontrolli i Blerësit.

10.3 Në rast se Blerësi shkel ndonjë nga zotimet e përcaktuara:

10.3.1 në paragrafin 10.1, Blerësi do t'i paguajë Shitësit një vlerë prej 80 000 000 (tetëdhjetë milionë) lekë për çdo shkelje si një ndëshkim kontraktor dhe

10.3.2 në paragrafin 10.2, Blerësi do t'i paguajë Shitësit një shumë të barabartë me vlerën e çmimit të shitjes si një ndëshkim kontraktor.

11. ZGJIDHJA E KONTRATËS

11.1 Kjo Kontratë mund të zgjidhet vetëm si më poshtë:

11.1.1 Me anë të marrëveshjes dypalëshe midis Shitësit dhe Blerësit, në datën e përcaktuar në të.

11.1.2 Nga Blerësi para fazës së parë të mbylljes nëse: a) ndodh dhe vazhdon të ekzistojë një ndryshim i rëndësishëm negativ në lidhje me Bankën për një periudhë për më tepër se (15) ditë-pune dhe pa u mënjeluar prej saj ose

b) Shitësi nuk zbaton detyrimet sipas paragrafit 5.4.2, me kusht që të jenë përmbushur të gjitha kushtet paraprake dhe që Blerësi të ketë zbatuar detyrimet e tij sipas paragrafit 5.3 dhe 5.4.1.

11.1.3 Përpara fazës së parë të mbylljes nga Shitësi nëse:

a) Blerësi kryen një shkelje thelbësore të ndonjë deklarami ose garancie, përfshirë në paragrafin 8 ose

b) Blerësi nuk zbaton detyrimet e tij të parashikuara në paragrafin 5.3 ose 5.4.1, me kusht që të jenë përmbushur të gjitha kushtet paraprake.

11.1.4 Nga secila palë, duke njoftuar me shkrim palën tjetër, nëse faza e parë e shitjes nuk është mbyllur deri më 13 korrik 2004 ose në një datë për të cilën të dyja palët kanë rënë dakord.

11.1.5 Nga secila palë, duke njoftuar me shkrim palën tjetër, nëse faza e dytë e shitjes nuk është mbyllur deri më 13 tetor 2004 ose në një datë të mëvonshme për të cilën kanë rënë dakord të dyja palët.

12. DISPOZITA TË MËTEJSHME

12.1 Palët do të koordinohen midis tyre për njoftimet publike në shtyp përse i përket vendimeve të parashikuara në këtë Kontratë.

12.2 Çdo njoftim me shkrim lidhur me këtë Kontratë, do të bëhet me postë rekomande, me shërbim postar të shpejtë ose faks dhe do të konsiderohet i kryer në kohë 5 (pesë) ditë-pune, pasi të jetë dorëzuar në postë dhe parapaguar për dërgesën, ose në rastin e shërbimit postar të shpejtë 2 (dy) ditë-pune pas dorëzimit në këtë shërbim ose, në rastin e njoftimit me faks (shoqëruar nga konfirmimi i marrjes), kur është dërguar në adresat ose numrat e mëposhtëm (ose në adresat dhe numrat e tjerë që palët ia japin njëra-tjetrës me njoftim me shkrim, të bërë në përputhje me paragrafin 12.2):

Për Shitësin:
Ministri i Financave

Për Blerësin tek:
Z. Jeffrey Millikan

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë Shqipëri

Adresa: Am Stadtpark 9
A-1030 Vjenë Austri

Tel: +355 4 228405
Faks: +355 4 228494

Tel: +4311717073413
Faks: +4311717072859

12.3 Kjo Kontratë, së bashku me shtojcat e saj (që përbëjnë pjesë integrale të këtij dokumenti) zëvendëson të gjitha negociatat dhe zotimet e mëparshme midis palëve në lidhje me përmbajtjen e saj, përveç Marrëveshjes së konfidencialitetit të datës 27 tetor 2003 dhe e zbatuar nga Blerësi në interes të Shitësit, këshilltarëve të tij dhe Bankës. Kjo Kontratë mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim nënshkruar nga të dyja palët.

12.4 Kjo Kontratë është hartuar në anglisht dhe shqip dhe të dyja tekstet janë origjinale. Në rast mospërputhjeje midis dy versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën angleze. Versioni në gjuhën shqipe mund të përdoret për efekt prove.

12.5 As kjo Kontratë dhe asnjë e drejtë apo detyrim që parashikohet në të nuk mund t'u kalohen të tretëve nga asnjëra palë, pa miratimin paraprak me shkrim të palës tjetër.

12.6 Kjo Kontratë realizohet në katër kopje, dy në anglisht dhe dy në shqip.

12.7 Titujt e paragrafëve të kësaj Kontrate janë shtuar për lehtësi dhe nuk përbëjnë pjesë të saj dhe as nuk dëmtojnë në asnjë mënyrë kuptimin ose interpretimin e kësaj Kontrate.

12.8 Çdo dispozitë e kësaj Kontrate do të interpretohet në mënyrë të tillë që të jetë e efektshme dhe e vlefshme sipas ligjit të zbatueshëm, sa herë që është e mundur, por, nëse ndonjë dispozitë e kësaj marrëveshjeje është e pazbatueshme ose e pavlefshme sipas ligjit të zbatueshëm, kjo dispozitë nuk do të ketë efekt vetëm për atë pjesë të pazbatueshmërisë dhe të pavlefshmërisë dhe dispozitat e mbetura të kësaj Kontrate do të vazhdojnë të mbeten të detyrueshme dhe në fuqi të plotë. Në rastin e një pavlefshmërie apo pazbatueshmërie të tillë, palët do të negociojnë me qëllimin e mirë për të rënë dakord mbi ndryshimet apo korrigjimet e bëra kësaj Kontrate, të cilat nevojiten për të arritur qëllimin e kësaj Kontrate nga pikëpamja e kësaj pavlefshmërie apo pazbatueshmërie.

12.9 Asnjë nga palët këtu nuk mund të heqë dorë nga ndonjë prej kushteve të kësaj Kontrate, me përjashtim të rastit kur dorëheqja është me shkrim dhe e nënshkruar nga pala përkatëse. Dorëheqja nga njëra palë për shkelje të ndonjë dispozite të kësaj Kontrate nuk do të ndikojë dhe nuk do të interpretohet si dorëheqje nga ndonjë dispozitë tjetër e kësaj Kontrate apo si ndonjë tjetër shkelje e dispozitës nga e cila është hequr dorë. Asnjë zgjatje e afatit për përmbushjen e detyrimeve apo akteve të kësaj Kontrate nuk do të konsiderohet si zgjatje afati për përmbushjen e detyrimeve apo akteve të tjera.

12.10 Përveç sa parashikohet në këtë Kontratë, palët do të paguajnë shpenzimet e tyre përkatëse lidhur me transaksionet e parashikuara në këtë Kontratë, përfshirë pa kufizim tarifat dhe shpenzimet e konsulentëve të tyre përkatës dhe atyre financiarë. Tarifat e Bankës së Llogarisë Escrow do të paguhën plotësisht nga Blerësi.

13. LIGJI I ZBATUESHËM DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

13.1 Kjo Kontratë do të rregullohet nga/dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

13.2 Çdo dhe të gjitha kundërshtitë që dalin në lidhje me këtë Kontratë apo prej saj, shkelje, ndërprerje apo pavlefshmëri ("Mosmarrëveshje") do të zgjidhen përfundimisht sipas paragrafit 13.2. Palët do të mundohen me mirëbesim për të zgjidhur çdo mosmarrëveshje me anë të negociatave pa iu drejtuar procedurave të arbitrazhit. Në rast se ka një mosmarrëveshje të tillë, cilado palë do t'i paraqesë një njoftim me shkrim palës tjetër ("Njoftim për mosmarrëveshje"), e cila propozon se palët kërkojnë të zgjidhin mosmarrëveshjen nëpërmjet negociatave. Nëse mosmarrëveshja nuk zgjidhet brenda 30 ditëve nga njoftimi për mosmarrëveshje, ajo do t'i adresohet dhe në fund do të zgjidhet nga arbitrazhi, me kërkesë të secilës palë, në përputhje me rregullat në fuqi UNCITRAL të Arbitrazhit ("Rregullat"). Do të ketë 1 (një) arbitër dhe organi që e emëron do të jetë Gjykata e Arbitrazhit Ndërkombëtar e Londrës. Vendi i arbitrazhit do të jetë Londra, Angli dhe në procedurat e arbitrazhit do të përdoret gjuha angleze. Vendimi përfundimtar i arbitrazhit mund të fillojë në çdo gjykatë që ka juridiksion. Secila palë pranon të mos kundërshtojë zbatimin e çdo vendimi arbitrazhi marrë në bazë të kësaj marrëveshjeje, përveç rasteve kur lejohet në mënyrë të shprehur ndryshe nga Konventa e New Yorkut 1958 për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj.

Tiranë, janar 2004

Ministri i Financave të Republikës së Shqipërisë

Raiffeisen Zentralbank Österreich Aktiengesellschaft

Nënshkruar nga Z.Jeffrey Millikan

Mbi bazën e prokurës së datës janar 2004

SHTOJCA A
FORMA E MARRËVESHJES PËR LLOGARINË ESCROW

SHTOJCA B
DEGËT E BANKËS, DETAJE TË SHOQËRIVE TË PËRBASHKËTA,
ORTAKËRIVE, PARTNERITETEVE DHE PERSONAVE JURIDIKË
TË PAREGJISTRUAR, PALË E SË CILËS ËSHTË BANKA

1. Banka zotëron 5.01 % të aksioneve (i barasvlefshëm me 343 973 (treqind e dyzet e tre mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tre) ECU të DV ALBTURIST HOTELIERS, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar që zotëron hotelin Tirana International.

Selia:	Sheshi "Skënderbej", Tiranë
Numri i regjistrimit në gjykatë:	Vendimi nr.5583, datë 13 korrik 1993
Data dhe vendi i themelimit:	13 korrik 1993, Tiranë
Drejtor i përgjithshëm:	Arian Skënderi
Anëtarët e Bordit Mbikëqyrës:	Arian Skënderi, Eduard Shalsi, Eva Hamitaj, Jonathan Roberts
Data e referimit ndaj llogarisë:	Qershor 2002
Revizorët:	KPMG
Kapitali i regjistruar:	6 865 730 ECU

2. Banka është anëtare e Shoqatës së Bankave Shqiptare.

3. Banka është anëtare e Institutit Botëror të Bankës së Kursimeve.

SHTOJCA C
LISTA E BARRAVE MBI TOKAT DHE NDËRTHESAT TË RENDITURA NË LLOGARITË
GJYSMËVJEÇARE TË SNK-SË

	PRONËSIA	BARRAT
1.	Lushnja	Ndërtesa ishte objekt i një padie dhe banka humbi të drejtën e pronësisë mbi të. Ka mundësi që Gjykata e Lartë të prishë dy vendimet e gjykatave më të ulta, duke e njohur kështu Bankën si zotërues, të së drejtës së pronësisë.
2.	Dega kryesore në Tiranë	Transferimi përfundimtar i së drejtës mbi 4000 m ² të ndërtesës është lënë pezull, si rezultat i disa problemeve në dokumentacion e paraqitur në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.
3.	Kioskë në Sarandë	Dhënë me qira për 3 000 lekë në muaj
4.	Zyrat në Kukës	Dhënë me qira për 5 000 lekë në muaj
5.	30 m ² në Peshkopi	Dhënë me qira fondit rural për 15 000 lekë në muaj
6.	12 m ² në Peshkopi	Dhënë me qira ATK-së për 12 USD në muaj për m ²
7.	32 m ² në Peqin	Dhënë me qira një pale të tretë

SHTOJCA D
PËRSHKRIMI I MBULIMIT TË DEGËVE RAJONALE SIPAS PARAGRAFIT 10.1

Blerësi, si institucioni qendror i Grupit Bankar Raiffeisen, është në dijeni të plotë të përgjegjësisë strategjike të Bankës për të siguruar një mbulim mbarëkombëtar të shërbimeve bankare. Blerësi pranon se është vendimtare për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të vendit. Blerësi bie dakord të vazhdojë të sigurojë cilësi të ngjashme të mbulimit rajonal prej datës së nënshkrimit të Kontratës së shitjes dhe për të zgjeruar konceptin e mbulimit, duke ofruar shërbime financiare të cilësisë së lartë si shoqërive, ashtu dhe individëve privatë. Nga sa më sipër, Blerësi do të sigurojë shërbime bankare universale nëpërmjet filialeve në rajonet kryesore të vendit dhe do të sigurojë shërbime shtesë nga rrjeti i filialit me shërbime alternative dhe mjetet shpërndarëse të përfshira:

- Automated Teller Machines (ATM)
- Shërbimet bankare nëpërmjet telefonëve celularë (veprimtari bankare mobile)
- Veprimtari bankare nëpërmjet internetit
- Qendrat e thirrjeve telefonike
- Agjentët e shitjeve mobile

SHTOJCA E
LLOGARIA GJYSMËVJEÇARE E SNK-SË

Datë _____ 2004

1) MINISTRIA E FINANCAVE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

2) RAIFFEISEN ZENTRALBANK OSTERREICH AKTIENGESELLSCHAFT
dhe

3) AMERICAN EXPRESS LTD

MARRËVESHJE ESCROW

Kjo Marrëveshje u nënshkrua ditën e
ndërmjet:

të janarit 2004 ("Marrëveshja")

1) Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministri i Financave, dhe duke vepruar në emër të shtetit shqiptar si pronari i vetëm i aksioneve në Bankën e Kursimeve të Shqipërisë ("Shitësi");

2) Raiffeisen ZentralBank Österreich Aktiengesellschaft, një shoqëri e themeluar në bazë të ligjeve të Austrisë, me seli në Am Stadtpark 9 A-1030 Vjena, Austria, përfaqësuar nga Z. Jeffrey Millikan me prokurë të datës 9 janar 2004 ("Blerësi") dhe

3) American Express Bank LTD, një person juridik i themeluar dhe që ushtron veprimtarinë në bazë të ligjeve të Shtetit të Connecticut, SHBA me seli në 200 Vesey Street, kati 22, New York, 10285, SHBA, përfaqësuar në Republikën e Shqipërisë nga Z. John Castaldo dhe Z. Anthony Oliveri seli në ("Banka Escrow").

Në të cilën:

A. Banka e Kursimeve të Shqipërisë u regjistrua si një person juridik sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë më 11 dhjetor 1992 në bazë të ligjit nr.7560, datë 28.4. 1992 dhe regjistruar në regjistrin tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë si shoqëri aksionere, me vendim gjyqi nr.17426 më 10 korrik 1997 dhe ka selinë në rrugën "Dëshmorët e 4 Shkurtit", nr.6, Tiranë ("Banka"). Kapitali i regjistruar i Bankës është 700 milionë lekë dhe përfshin 7 mijë aksione me vlerë nominale 100 000 lekë secili.

B. Shitësi është pronari i regjistruar i të gjithë kapitalit të regjistruar të Bankës.

C. Në bazë të ligjit nr.8536, datë 22 dhjetor 1999 "Mbi përkufizimin e formës dhe formulës së privatizimit të Bankës së Kursimeve të Shqipërisë" dhe vendimet nr.452 dhe 630 të Këshillit të Ministrave datë 28 qershor 2001 dhe 18 shtator 2003, respektivisht, Shitësi ofroi të shesë 35 deri 100% të kapitalit të regjistruar të Bankës, nëpërmjet një tenderi të hapur ndërkombëtar.

D. Në 23 shtator 2003, me anë të shpalljes në gazeta, Shitësi ftoi palët e interesuara të dorëzojnë letrën e interesit për të përfutur pronësi aksionesh strategjike në Bankë.

E. Në 25 tetor 2003, Shitësi shpalli investitorët e interesuar strategjikë të cilësuar si të suksesshëm dhe i ftoi ata të marrin pjesë në procedurën e tenderit.

F. Gjatë periudhës 3 nëntor 2003 deri në 21 nëntor 2003, Blerësi vizitoi një mori të dhënash që përfshinin të dhëna tregtare, ligjore, operative dhe financiare për Bankën dhe ndërmori analiza dhe rishikime të pavarura rreth Bankës.

G. Blerësi i dorëzoi një ofertë detyruese Shitësit në datën 17 dhjetor 2003.

H. Më datë 20 dhjetor 2003 Këshilli i Ministrave miratoi Blerësin si ofertuesi më i mirë, në përputhje me vendimin e Komisionit të vlerësimit të ofertave.

I. Në datën e sotme, Shitësi dhe Blerësi do të nënshkruajnë një marrëveshje për shitje aksionesh dhe blerje ("Marrëveshja për blerje aksionesh"), sipas të cilës Blerësi do të jetë i detyruar të transferojë çmimin e blerjes për aksionet në shitje.

Duke u bazuar në sa më sipër, palët bien dakord si në vijim:

1. PËRKUFIZIMET

Fjalët dhe termet e përkufizuar në Marrëveshjen e blerjes së aksioneve, përveç rasteve ku përkufizohen shprehimisht ndryshe, do të kenë të njëjtin kuptim në këtë Marrëveshje.

2. CAKTIMI I BANKËS SË LLOGARISË ESCROW

Shitësi dhe Blerësi bien dakord të caktojnë Bankën e Llogarisë Escrow si Banka e Llogarisë Escrow në këtë Marrëveshje dhe Banka e Llogarisë Escrow e pranon këtë emërim.

3. DEPOZITIMI I ÇMIMIT TË BLERJES

3.1 Në datën e kësaj Marrëveshjeje, Banka e Llogarisë Escrow do të krijojë një Llogari Escrow me vlerë interesi në dollarë amerikanë me emrin "Llogaria Escrow e Ministrisë së Financave të Shqipërisë/ RZB" dhe do të japë të gjitha të dhënat e kësaj Llogarie me shkrim për Shitësin dhe Blerësin ("Llogaria Escrow").

3.2 Brenda tre ditë-pune nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes për blerjen e aksioneve, Blerësi do të transferojë në Llogarinë Escrow një shumë të barabartë me 10% (dhjetë) të çmimit të blerjes ("Depozita").

3.3 Brenda një ditë pune nga pranimi i depozitës, Banka e Llogarisë Escrow do të dërgojë një konfirmim të pranimit për secilin, Shitësin dhe Blerësin në formën e dhënë në shtojcën 1 të kësaj Marrëveshjeje.

3.4 Në përputhje me detyrimet e paragrafit 5 të Marrëveshjes së blerjes së aksioneve, Blerësi do të transferojë në Llogarinë Escrow një shumë të barabartë me 90 % (nëntëdhjetë) të çmimit të Blerjes në mbylljen e parë ("Shuma e mbylljes së parë").

3.5. Brenda një ditë-pune nga pranimi i shumës së mbylljes së parë, Banka e Llogarisë Escrow do të dërgojë një konfirmim të pranimit për secilin, Shitësin dhe Blerësin në formën e dhënë në shtojcën 1 të kësaj Marrëveshjeje.

4. LLOGARIA ESCROW

4.1 Banka e Llogarisë Escrow do të mbajë shumën e llogarisë Escrow për Shitësin dhe Blerësin dhe do të zbatojë të gjitha dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, në lidhje me shumën Escrow.

4.2 Banka e Llogarisë Escrow do të mbajë qartë në regjistrat e veta Llogarinë Escrow si një Llogari Escrow dhe do të mbajë fondet e lidhura me kreditë e saj, të ndara nga fondet e Bankës së Llogarisë Escrow, si dhe nga fondet e ndonjë klienti apo pale të tretë.

4.3 Çdo interes i përftuar nga Llogaria Escrow do të ruhet në Llogarinë Escrow dhe për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje do të trajtohet në të njëjtën mënyrë si dhe çmimi i blerjes i depozituar nga Blerësi. Të gjitha interesat ose shtesat në lidhje me shumën Escrow do të paguhen ndaj palës së cilës do t'i çlirohet shuma Escrow në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

4.4 Palët bien dakord që të gjitha shumat, në lidhje me kreditin e Llogarisë Escrow, do të investohen nga Banka e Llogarisë Escrow në depozita 24-orëshe në dollarë amerikanë në një ose më shumë banka të fuqishme që ushtrojnë veprimtarinë në tregun interbankar europian. Banka e Llogarisë Escrow do të mbajë të gjitha të dhënat për interesat dhe shtesat e fituara nga investime të tilla.

5. ÇLIRIMI I ÇMIMIT TË BLERJES

5.1 Sapo të marrë nga njëra palë, Blerësi ose Shitësi:

a) një origjinal ose një kopje të noterizuar të vendimit të Gjykatës së Rrethit Tiranë dëshmon se aksionet e shitura janë regjistruar në emrin e Blerësit ose

b) një udhëzim të dhënë sipas formës në shtojcën 2 të nënshkruar nga Shitësi dhe Blerësi.

Banka e Llogarisë Escrow do të transferojë shumën e plotë të kredituar në Llogarinë Escrow, së bashku me ndonjë interes të mbledhur mbi të për Shitësin.

5.2 Nëse Banka e Llogarisë Escrow nuk merr ndonjërin nga dokumentet e përmendura në paragrafët 5.1 (a) ose 5.1 (b) deri më 12 tetor 2004, Banka e Llogarisë Escrow do të:

a) njoftojë Shitësin dhe Blerësin për këtë fakt;

b) (i) me marrjen e një udhëzimi me shkrim të nënshkruar nga Shitësi dhe Blerësi, të çlirojë shumat e kredituara në Llogarinë Escrow, në përputhje me udhëzimet e dhëna me shkrim;

(ii) me marrjen e vendimit përfundimtar nga arbitri i caktuar sipas paragrafit 13 të Marrëveshjes për shitje aksionesh ose atë 11 të kësaj Marrëveshjeje, Banka e Llogarisë Escrow do të livrojë shumat e kredituara në Llogarinë Escrow, në përputhje me një vendim të tillë arbitrazhi;

(iii) me marrjen e njoftimit me shkrim të zgjidhjes së Kontratës të adresuar nga Blerësi ose Shitësi për palën tjetër, në bazë të Marrëveshjes për shitje aksionesh që shprehimisht zgjidhin këtë kontratë në bazë të paragrafit 11.1.5 të saj, me kusht që Banka e Llogarisë Escrow të mos ketë marrë dëshmi të shpallura, Banka e Llogarisë Escrow do t'i lëshojë Blerësit shumat e maturuara të kreditit të Llogarisë Escrow.

6. DETYRIMET E BANKËS SË LLOGARISË ESCROW

6.1 Detyrimet e Bankës së Llogarisë Escrow, sipas kësaj Marrëveshjeje do të jenë si më poshtë:

6.1.1 Banka e Llogarisë Escrow nuk mban asnjë përgjegjësi për vërtetësinë ose vlefshmërinë e njoftimeve, dokumenteve të tjera ose instrumenteve të paraqitura para saj, si dhe është e mbrojtur në të gjitha veprimet e kryera prej saj, në bazë të një njoftimi të shkruar, heqje dorë, pranimi,

mandatpagese ose çdo provë apo instrumenti tjetër për të cilën Banka në mirëbesim pranon vërtetësinë dhe nënshkrimin dhe të jetë nënshkruar nga një person i autorizuar.

6.1.2 Banka e Llogarisë Escrow nuk do të jetë e detyruar të ndërmarrë asnjë hap për të verifikuar nëse ka ndodhur ndonjë ngjarje, e cila mund të ndikojë mbi këtë Marrëveshje.

6.1.3 Bankës së Llogarisë Escrow nuk do t'i kërkohet të ndërmarrë ndonjë veprim me anë të cilit do të shkelë ndonjë ligj apo rregulla të zbatueshme të cilitdo autoritet shtetëror ose rregulator.

7. TË DHËNAT E PAGESËS

Të gjitha pagesat, në lidhje me shumën Escrow (dhe ndonjë interes i mbledhur mbi të), do të bëhen në rastin e Shitësit ndaj kësaj llogarie, siç mund të njoftohet herë pas here nga Shitësi me shkrim, Banka e Llogarisë Escrow dhe në rastin e Blerësit ndaj kësaj llogarie siç mund të njoftohet herë pas here nga Blerësi me shkrim, Banka e Llogarisë Escrow.

8. TË PËRGJITHSHME

8.1 Kjo Marrëveshje, së bashku me shtojcat (që përbëjnë pjesë integrale të saj), dominon të gjitha negociatat dhe ujdite paraprake mes palëve në lidhje me objektin e përfshirë në këtë Marrëveshje. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me një dokument të nënshkruar nga të dyja palët.

8.2 Kurdo që të jetë e mundur, çdo dispozitë e kësaj Marrëveshjeje do të interpretohet në mënyrë të tillë që të jetë e vlefshme dhe e efektshme sipas ligjeve bazë, por, nëse ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje do të jetë e pavlefshme ose e paefektshme sipas ligjeve në fuqi, kjo dispozitë do të jetë e pavlefshme ose e paefektshme vetëm për atë që pavlefshmëri ose paefektshmëri, dhe dispozitat e tjera të Marrëveshjes do të vazhdojnë të jenë të detyrueshme dhe me efekt të plotë. Në rast të një pavershmërie ose pazbatueshmërie të tillë, palët në këtë Marrëveshje do të negociojnë me mirëbesim për të rënë dakord mbi ndryshimet e kësaj Kontrate që nevojiten për përmbushjen e saj nga pikëpamja e kësaj pazbatueshmërie ose pavlefshmërie.

8.3 Të gjitha pagesat, lidhur me këtë Marrëveshje, do të bëhen të plota pa ndonjë shlyerje apo kundërkërkesë dhe të lirë nga zbritjet ose mbajtjet.

8.4 Blerësi do të jetë përgjegjës vetëm për tarifat dhe kostot e tjera të Bankës së Llogarisë Escrow që dalin në lidhje me këtë Kontratë.

8.5 As Banka e Llogarisë Escrow dhe as ndonjëri nga drejtorët, nëpunësit, agjentët ose punonjësit e saj nuk do të jenë përgjegjës për kryerjen ose moskryerjen e ndonjë veprimi nga Banka ose ata, në bazë të ose lidhur me këtë Kontratë, përveç shkeljes së kushteve të kësaj Kontrate ose veprime neglizhuere ose shkelje me qëllim. Pa kufizuar përgjithësinë e sa më sipër, Banka e Llogarisë Escrow: (i) nuk bën deklarime dhe garanci lidhur me këtë Kontratë, përveç atyre të shprehura në paragrafin 8.8 më poshtë; (ii) nuk do të ketë për detyrë të sigurojë ose të hetojë për kryerjen ose respektimin nga palët të secilit prej kushteve, premtimeve ose afateve të Kontratës së shitjes apo ndonjë Marrëveshje e ndryshme nga kjo Marrëveshje; (iii) mundet që me shpenzimet e saj të këshillohet me këshilltarë ligjorë të zgjedhur prej saj; (iv) nuk do të pësojë ndonjë përgjegjësi sipas ose lidhur me këtë Kontratë, duke vepruar mbi bazën e ndonjë njoftimi, leje, certifikate ose instrumenti tjetër, lëshuar në përputhje me këtë Marrëveshje të konsideruara nga Banka e Llogarisë Escrow (pasi janë bërë hetimet e duhura dhe të arsyeshme) në mirëbesim si të vërteta dhe të nënshkruara apo si të dërguara nga pala/palët e duhur(a) dhe në rastin e Blerësit të nënshkruar nga persona të autorizuar sipas nënshkrimit të specifikuar.

8.6 Blerësi do të kompensojë plotësisht dhe të mos cenojë Bankën e Llogarisë Escrow kundrejt dhe lidhur me: (i) ndonjë pretendim ngritur ndaj Bankës së Llogarisë Escrow, si rezultat i kryerjes ose moskryerjes së veprimeve, lidhur me transaksionet e parashikuara këtu; (ii) ndonjë humbje të Bankës së Llogarisë Escrow të pësuar gjatë përmbushjes së kushteve të kësaj Kontrate, duke përfshirë tarifa të arsyeshme dhe shpenzimet e këshillimit; megjithatë me kushte që Banka e Llogarisë Escrow nuk do të ketë të drejtë të kompensohet, lidhur me ndonjë pretendim ose humbje të shkaktuar nga ose, si rrjedhojë e neglizhencës ose shkeljeve me qëllim.

8.7 Kjo Kontratë është nënshkruar në të gjitha ekzemplarët dhe në ekzemplarë të tjerë nga palët.

8.8 Secila palë i garanton dhe i deklaron palës tjetër se ajo gëzon kompetencë të plotë, autoritet dhe të drejtë ligjore për të marrë mbi vete detyrimet, për të nënshkruar, dorëzuar dhe përmbushur kushtet dhe dispozitat e kësaj Kontrate. Kjo Kontratë është detyrim i vlefshëm ligjor i kësaj pale, i zbatueshëm në përputhje me kushtet e saj dhe nuk bie në konflikt me asnjë ligj, rregull ose instrument detyrues për apo lidhur me këtë palë, dhe se kjo kontratë është brenda kompetencave të saj dhe është autorizuar rregullisht prej saj, se janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme, janë dhënë të gjitha lejet dhe miratimet e nevojshme për të autorizuar nënshkrimin, dorëzimin dhe përmbushjen e kësaj Kontrate dhe se personi që nënshkruan këtë Kontratë në emër të secilës palë është i autorizuar për këtë. Secila palë, në mënyrë të pakthyeshme dhe të pakushtëzuar, heq dorë nga çdo imunitet (që i vishet për arsye të sovranitetit apo për të tjera arsye) në kufirin e plotë të lejuar nga ligji.

8.9 Banka e Llogarisë Escrow, do të marrë tarifën për Llogarinë Escrow për shërbimet që do të sigurohen në bazë të kësaj Kontrate, të cilat do të paguheshin plotësisht nga Blerësi. Banka e Llogarisë Escrow dhe Blerësi i deklarojnë dhe i garantojnë Shitësit se tarifa e Llogarisë Escrow është një pagesë e mjaftueshme për shërbimet e parashikuara sipas kësaj Kontrate dhe është një shumë e cila është në pajtim me tarifat standarde të bankave, të cilat veprojnë me cilësinë e agjentit të Llogarisë Escrow në transaksionet e një vlere dhe lloji të ngjashëm me transaksionet e parashikuara në këtë Kontratë.

9. NJOFTIMET

9.1 Palët do të koordinojnë me njëra-tjetrën lidhur me njoftimet publike të nxjerra në shtyp përse i përket transaksioneve të parashikuara në këtë Kontratë.

9.2 Çdo njoftim me shkrim lidhur me këtë Kontratë do të bëhet me postë rekomandë, me shërbim korrier ekspres ose faks dhe do të konsiderohet i kryer në kohë pesë ditë, pasi të jetë postuar dhe parapaguar, ose në rastin e shërbimit korrier ekspres dy ditë-pune pas dorëzimit në këtë shërbim, ose në rastin e njoftimit me faks (shoqëruar nga konfirmimi i marrjes), kur është dërguar në adresat ose numrat e mëposhtëm (ose në adresat dhe numrat e tjerë që palët ia japin njëra-tjetrës me njoftim të bërë në përputhje me paragrafin 9.2):

Nëse për Shitësin në adresën:

Ministri i Financave

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"

Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 228405 Faks: +355 4 228494

Në vëmendje të z. Rezart Turdiu

Nëse për Blerësin në adresën:

Z. Jeff Millikan

Adresa: Am Standtpark 9

A-1030 Vjenë Austria Tel: 431 1 717 073 413

Fax: 431 1 717 07 2859

Nëse për Bankën e Llogarisë Escrow në adresën:

American Express Bank Ltd Adresa 200 Vesey Street

22nd Floor

New York, 10285

USA

Tel: 1 212 640 4085 Fax: 1 212 640 4222

Në vëmendje të Z.Farhad Subjally, Senior Director

10. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

10.1 Kjo Marrëveshje do të udhëhiqet nga/dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

10.2 Çdo dhe të gjitha mosmarrëveshjet e ngritura në lidhje me këtë Marrëveshje apo prej saj, shkelje, ndërprerje apo pavlefshmëri po aty (një "Mosmarrëveshje") do të zgjidhet sipas paragrafit 10.2. Palët do të mundohen me qëllimin e mirë për të zgjidhur çdo mosmarrëveshje me anë të negociatave, pa iu drejtuar procedurave të arbitrazhit. Në rast se ka një debat të tillë, cilado palë do t'i paraqesë një njoftim me shkrim palës tjetër (një "Njoftim për mosmarrëveshje") e cila propozon se palët kërkojnë të zgjidhin mosmarrëveshjen nëpërmjet negociatave. Nëse mosmarrëveshja nuk zgjidhet brenda 30 ditëve nga njoftimi për mosmarrëveshje, ajo do t'i adresohet

dhe në fund do të zgjidhet nga arbitrazhi, me kërkesë të cilësdo palë, në përputhje me rregullat UNCITRAL të arbitrazhit në fuqi ("Rregullat").

Do të ketë një arbitër dhe organi që e emëron do të jetë Gjykata Ndërkombëtare e Londrës për Arbitrazhin. Vendi i arbitrazhit do të jetë Londra në Angli dhe gjatë procedimit arbitrar do të përdoret gjuha angleze. Vendimi përfundimtar arbitral mund të fillojë në çdo gjykatë me kompetencë për juridiksion. Secila palë bie dakord të mos kundërshtojë zbatimin e ndonjë vendimi arbitral marrë në bazë të kësaj Marrëveshjeje, përveçse sa lejuar qartë nga Konventa e New Yorkut 1958, lidhur me njohjen dhe zbatimin e një vendimi arbitrazhi të huaj.

Në prani të dëshmitarëve, Palët kanë bërë që kjo Kontratë të nënshkruhet në datën e paraqitur më sipër.

MINISTRI I FINANCAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

RAIFFEISEN ZENTRALBANK OSTERREICH AKTIENGESELLSCHAFT

Nënshkruar nga Jeffrey Millikan
Me prokurë të datës janar 2004

AMERICAN EXPRESS LTD

Emri: John S. Castaldo
Titulli: Menaxher i Përgjithshëm

Emri: Anthony J. Oliveri
Menaxher i Përgjithshëm

PJESA 1
LETËR NGA BANKA E LLOGARISË ESCROW PËR BLERËSIN DHE
SHITËSIN
(LETËR ME KOKË E BANKËS SË LLOGARISË ESCROW)

Për: Ministrinë e Financave
Dhe: Raiffeisen Zentralbank Österreich Aktiengesellschaft

I nderuar Zotëri,

dhënë dorazi

Nëpërmjet kësaj letre vërtetojmë që në [DATA E DEPOZITIMIT TË DEPOZITËS OSE SHUMA E PARË E MBYLLUR (SIÇ APLIKOHET)] shuma e USD () u depozitua në llogarinë e mëposhtme: (DETAJE PËR LLOGARINË ESCROW).

Vërtetojmë që të gjitha shumat e tilla janë marrë prej nesh në këtë llogari në vijim të termave të një Marrëveshjeje për Llogarinë Escrow të nënshkruar nga ne, Shitësi dhe Blerësi (siç janë përshkruar këtu) në

I Juaji,

Për dhe në emër të American Express Bank Ltd.

PJESA 2
UDHËZIME PËR ZHBLLOKIMIN E SHUMËS ESCROW

[LETËR ME KOKË E MINISTRISË SË FINANCAVE TË SHQIPËRISË]

Për: American Express Bank Ltd.

I nderuar Zotëri,

Duke iu referuar pikës 5.1 të Marrëveshjes për Llogarinë Escrow , datë (shkruani datën e Marrëveshjes për Llogarinë Escrow), të përfunduar nga ju dhe ne ("Marrëveshja"), ju autorizojmë dhe ju udhëzojmë të zhbllokoni shumën e plotë të çmimit të blerjes (sipas termave të përcaktuar në Marrëveshje) dhe t'i paguani të njëjtën shumë Shitësit, në përputhje me paragrafin 7 të Marrëveshjes.

Datë: ()

Ministria e Financave të Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministri i Financave

Raiffeisen Zentralbank Österreich Aktiengesellschaft

VENDIM
Nr.7, datë 14.1.2004

PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT TË BISEDIMEVE, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS
FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR DHE TEKNIK PËR
VITIN 2003

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 dhe 23 të ligji nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e protokollit të bisedimeve, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar dhe teknik për vitin 2003.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

PROTOKOLLI I REZULTATEVE TË BISEDIMEVE PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR E TEKNIK TË QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË PËR VITIN 2003

Nga data 24 deri në 25 nëntor 2003 në Tiranë u zhvilluan bisedimet midis delegacionit të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe delegacionit të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë për bashkëpunimin financiar dhe teknik.

Delegacioni gjerman u kryesua nga z. Dr. Leo Kreuz, drejtues seksioni në Ministrinë Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim. Drejtues i delegacionit shqiptar ishte Zëvendësministri i Ekonomisë, z. Luan Shahollari.

Listat e pjesëmarrësve të të dy delegacioneve janë bashkëngjitur si shtojca.

Bisedimet u zhvilluan në një atmosferë të hapur e konstruktive dhe u karakterizuan nga mirëkuptimi i ndërsjellë.

Drejtuesi i delegacionit shqiptar përshëndeti miqtë gjermanë dhe hapi bisedimet qeveritare.

Ai shprehu konsideratën më të lartë për bashkëpunimin e shkëlqyer 15-vjeçar me Republikën Federale të Gjermanisë, si dhe falënderoi Qeverinë gjermane për mbështetjen në procesin e pandalshëm të zhvillimit të demokracisë dhe të ekonomisë së tregut në vend. Në janar të këtij viti u nënshkrua në Tiranë hapja zyrtare e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit të Shqipërisë me BE-në. Qeveria shqiptare përshëndeti iniciativat e Qeverisë gjermane për sensibilizimin e qeverive të vendeve të tjera të industrializuara dhe të institucioneve ndërkombëtare financiare për të mbështetur procesin e integritit të Shqipërisë në strukturat europiane. Me qëllim nxitjen e investimeve të huaja, si dhe për të përshpejtuar ritmet e zhvillimit ekonomik të vendit, në vitin 2003 janë ngritur tri agjenci të reja: Agjencia e nxitjes së investimeve të huaja, Agjencia për nxitjen e eksporteve, si dhe Agjencia për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Me këtë Qeveria shqiptare synon forcimin e sistemit liberal të tregtisë dhe të bashkëpunimit rajonal. Ekonomia shqiptare duhet të bëhet një pjesë reale e tregut rajonal prej 56 milionë banorësh. Qeveria shqiptare ka përmbushur në kohën e duhur detyrimet që dalin nga memorandumit i mirëkuptimit i qershorit 2001, duke nënshkruar marrëveshje të tregtisë së lirë me të gjitha vendet e rajonit. Kjo përvojë na shërben aktualisht në kuadrin e bisedimeve për nënshkrimin e një marrëveshjeje të tregtisë së lirë me BE-në. Qëllimi prioritar i Qeverisë së Shqipërisë është integrimi i Shqipërisë në BE. Në takimin e fundit mes Komisionit Europian dhe delegacionit të Qeverisë shqiptare u vlerësuan pozitivisht hapat e ndërmarra deri tani dhe u përcaktuan detyrat e ardhshme për përshpejtimin e reformave në të gjitha fushat. Në përfundim drejtuesi i delegacionit shqiptar shprehu bindjen e tij të thellë që bashkëpunimi i frytshëm dhe konkret, si dhe atmosfera e ngrohtë dhe miqësore mes dy vendeve tona do të vijojë edhe në të ardhmen, dhe se Shqipëria sheh në Republikën Federale të Gjermanisë një mik dhe partner të besueshëm në rrugën e saj drejt integritit në BE.

Drejtuesi i delegacionit gjerman falënderoi për zemërsisht për përshkrimin interesant të gjendjes ekonomike dhe procesit të përafrimit me BE-në. Para 15 vjetësh, kur filloi bashkëpunimi dypalësh për zhvillim, një proces i tillë ishte i paparashikueshëm. Kur para pak kohësh, në praninë e Sekretarit të Shtetit Stather, ne festuam 15-vjetorin e bashkëpunimit, u bë e qartë se Shqipëria ka bërë hapin më të madh të zhvillimit në rajonin europian. Gjermania e ka mbështetur Shqipërinë pavarësisht nga qeveritë. Megjithë situatën e vështirë të buxhetit të saj, Gjermania do t'i vërë në dispozicion Shqipërisë 16 milionë euro për vitin 2003. Kjo thekson rëndësinë e këtij bashkëpunimi. Një projekt i rëndësishëm dhe njëkohësisht me kërkesa shumë të larta është furnizimi me ujë i Elbasanit. Ky projekt duhet t'u hapte dyert investimeve direkte të huaja. Por momentalisht ai gjendet në një situatë kritike. Në rast se ky projekt nuk mund të futet në një rrugë të mbarë, fondet e premtuara për të duhet të përdoren në projekte të tjera. Një kusht i rëndësishëm për suksesin e projektit do të jetë përmbushja e detyrimeve kontraktuale.

Pala gjermane do të mbështesë edhe për disa muaj një qendër sociale për fëmijët në Tiranë. Ajo do të përshëndesë faktin nëse Qeveria shqiptare do të mund ta mbështesë financiarisht këtë qendër. Përgjithësisht bashkëpunimi bilateral ka qenë gjithmonë shumë i frytshëm dhe është karakterizuar nga respekti dhe besimi i ndërsjellë. Një qëllim i rëndësishëm i përbashkët është integrimi i Shqipërisë në strukturat europiane. Hapat më të rëndësishme në këtë drejtim duhet të

ndërmerren nga populli dhe Qeveria shqiptare. Gjermania është e gatshme ta mbështesë, sipas mundësive, edhe më tej këtë përpjekje të tyre.

Të dyja palët mbështesin fushat kryesore të bashkëpunimit dypalësh: furnizimin me ujë të pijshëm dhe kanalizimet e ujërave të zeza (menaxhim ujërash); reforma e energjisë dhe ekonomisë) ndërtimi i ekonomisë së tregut, që nëpërmjet ndikimit të tyre në grupe të synuara të varfëra japin një ndihmesë të veçantë politike zhvillimore për luftimin e varfërisë në kuptimin e programit të veprimit 2015 të Qeverisë Federale.

Pala shqiptare informoi lidhur me gjendjen e negocimit të Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asocimit me Bashkimin Europian. Pala gjermane deklaroi se ajo vazhdon të jetë e gatshme të mbështesë procesin e përafrimit me Bashkimin Europian në kuadrin e bashkëpunimit financiar dhe teknik.

Të dyja palët ranë dakord që projektet brenda fushave të miratuara në bisedimet qeveritare 2003 të kontribuojnë në përmirësimin e kushteve të përgjithshme shoqërore dhe ekonomike të Shqipërisë dhe në këtë mënyrë të japin një ndihmesë të qenësishme për zhvillimin e mëtejshëm të vendit drejt Bashkimit Europian.

Drejtuksi i delegacionit gjerman deklaroi se brenda buxhetit 2003 për projekte të bashkëpunimit financiar dhe teknik miratohen gjithsej 16 milionë euro.

Bashkëpunimi financiar (BF)

1.1 Bashkëpunimi në vijim dhe aspekte themelore

Të dyja palët përshëndetën rivlerësimin e zyrës së KfW-së dhe dërgimin e z.Dr.Lütke Wöstmann si drejtues të zyrës si një ndihmesë të rëndësishme për intensifikimin e mëtejshëm të bashkëpunimit shqiptaro-gjerman.

Për çështjet e bashkëpunimit financiar në vijim, si dhe për aspektet themelore, përkatësisht të përgjithshme, u trajtuan në veçanti temat e mëposhtme:

1.1.1 Të përgjithshme

Të dyja palët ishin dakord për atë, që është e domosdoshme që koha administrative përgatitore për projektet e bashkëpunimit financiar të kufizohet në një minimum. Pika të rëndësishme këtu janë përfundimi i shpejtë i marrëveshjes qeveritare, kontratat e huave dhe të financimit, si dhe paraqitja në kohë e konfirmimeve ligjore përkatëse të domosdoshme, si p.sh. ratifikimi nga Kuvendi ose vlerësimet e Ministrisë së Drejtësisë. Në raste urgjente është i mundur - përjashtimisht - edhe një parafinancim i aktiviteteve të projektit nga mjetet e fondit për studime dhe ekspertë.

1.1.2 Fusha e furnizimit me ujë dhe e kanalizimeve të ujërave të zeza

Pala gjermane e nxiti Qeverinë shqiptare të vazhdojë me konsekuencë rrugën e nisur të reformës për menaxhimin e ujit.

Të dyja palët ranë dakord që, përveç vazhdimin të procesit të decentralizimit, të ndiqen më tej gjithashtu tema, si pjesëmarrja dhe përfaqësimi i përshtatshëm i grupeve të synuara (p.sh. në këshillat mbikëqyrës të ndërmarrjeve furnizuese), si dhe reforma tarifore dhe marrja përsipër nga pushteti qendror i borxheve të kaluara të ndërmarrjeve të komercializuara. Zbatimi i shpejtë i hapave të iniciuar të reformës duhet të ketë edhe në të ardhmen përparësi të dorës së parë.

Furnizimi me ujë dhe kanalizimet e ujërave të zeza në Shkodër

Pala gjermane informoi që vazhdimi i projektit ka vetëm atëherë kuptim, në qoftë se luftohen me siguri deficitet ekzistuese në fushën e furnizimit me ujë. Pala shqiptare propozoi që mjetet e parashikuara të përdoren pikë së pari me përparësi për furnizimin me ujë në Shkodër. Në raste emergjente në fushën e kanalizimeve do të verifikohen masa të veçanta në një fazë të mëpasshme përgatitore.

Furnizimi me ujë dhe kanalizimet e ujërave të zeza në zonën në Veri të Shqipërisë (Bajram Curri).

Pala gjermane informoi se një hulumtim i parë i bëshmërisë së një projekti të madh e të shtrenjtë të ujit të pijshëm e kanalizimeve të ujërave të zeza arriti në një rezultat negativ. Por, duhet të financohen hulumtime të mëtejshme dhe eventualisht masa urgjente përparësore në fushën e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të zeza.

Furnizimi me ujë dhe kanalizimet e ujërave të zeza në Pogradec

Pala gjermane tërhoqi vëmendjen se zgjidhja teknologjike e përparuar, e parashikuar deri tani për pastrimin e ujërave të zeza vërtet që është e dëshirueshme, por kostot e larta operative që rrjedhin prej saj nuk do të mund të mbuloreshin vetëm prej pagesave tarifore të popullsisë. Për këtë arsye duhet të gjenden zgjidhje teknikisht më të thjeshta. Përveç kësaj duhet verifikuar nëse një pjesë e kostove operative do të mund të mbuloreshin nga pushteti qendror për të mbrojtur trashëgiminë natyrore botërore.

Më tej, pala gjermane sqaroi se mungesa e gatishmërisë për bashkëpunimin e menaxhuesve të ndërmarrjes së furnizimit me ujë (UK Pogradec) rrezikonte suksesin e projektit. Pala gjermane përshëndeti palën shqiptare për ristrukturimin e stafit menaxhues të ndërmarrjes së furnizimit me ujë (UK Pogradec). Më tej nevojitet urgjentisht një përmirësim i qartë i situatës menaxhuese të ndërmarrjes. Pala shqiptare merr përsipër të realizojë sa më shpejt përmirësimin e kërkuar, angazhohet plotësisht për plotësimin e mangësive të dala në procesin e zbatimit të projektit, duke marrë të gjitha masat e nevojshme në kohë sa më të shpejtë.

Furnizimi me ujë dhe kanalizimet e ujërave të zeza në Elbasan

Pas një viti e gjysmë operimi, ndërmarrja koncesionare Elber ndodhet në një situatë ekonomike shqetësuese. Pala gjermane tërhoq vëmendjen se është patjetër e domosdoshme që të respektohen me rreptësi përcaktimet kontraktuale të koncesionit. Për shkak të mungesës së mbështetjes në nivel komunal është penguar deri tani zbatimi në mënyrë të mjaftueshme i programit për instalimin e matësve. Barrë të mëtejshme financiare për Elber përbën edhe refuzimi i rritjes së tarifave (parashikuar në kontratë nga ana e këshillave komunale dhe enteve rregullatore), si dhe kërkesat e parealizueshme, në lidhje me tatimin mbi xhiron.

Si rrjedhojë e kësaj situatë, pala gjermane e konsideron suksesin e projektit si shumë të rrezikuar dhe i kërkon palës shqiptare që menjëherë të japë ndihmesën për zbatimin e programit të instalimit të matësve, si kusht paraprak themelor për të mbështetur furnizimin me ujë në Elbasan. Më tej pala gjermane kërkon mundësimin, brenda një kohe të shkurtër, e rritjes së tarifave në përputhje me kontratën dhe gjetjen e një zgjidhjeje për problemin e tatimit mbi fitimin. Pala gjermane tërhoq vëmendjen se kufizimi tejet i fortë i interesave ekonomike të një operatori privat e bën të pamundur shfrytëzimin e premisave të Public-Privat-Partnership (PPP) për një funksionim të qëndrueshëm të sistemeve të furnizimit me ujë.

Pala gjermane përshëndeti propozimin e delegacionit shqiptar për të thirrur në një periudhë të shkurtër një "task-forcë", me përfaqësues të institucioneve shqiptare dhe të "Elber sh.p.k.", nën drejtimin e Zëvendësministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit. Një përfaqësues i KfW-së do të marrë pjesë në seancat e "task-forcë". Kjo "task-forcë" duhet që të përcaktojë një program pune me referenca të qarta kohore për probleme ekzistuese, i cili duhet të miratohet nga palët pjesëmarrëse, si dhe të monitorojë realizimin e tij.

Furnizimi me ujë Kukës/Has/Kavajë

Vlerësimi i këtyre projekteve të mbyllura tregon se futja e tarifave që mbulojnë kostot, si dhe një përmirësim i ndjeshëm i rendimentit e vullnetit për reforma nga ana e menaxhimit, janë parakushte themelore për një funksionim të qëndrueshëm. Kështu që masat shoqëruese në sektorin e ujit në të ardhmen duhet të orientohen edhe më fort nga këto aspekte.

1.1.3 Fusha e energjisë

Pala gjermane vlerësoi rezultatet e arritura deri tani në zbatimin e planit shqiptar të veprimt për mëkëmbjen ekonomike dhe teknike të ekonomisë së energjisë elektrike. Ajo e nxiti Qeverinë shqiptare dhe ndërmarrjen e furnizimit me energji elektrike KESH të vazhdojnë në përpjekjet e tyre për rritjen e arkëtimeve dhe të zvogëlimin të humbjeve joteknike. I një rëndësie të veçantë është për këtë përmirësimi i identifikimit të konsumit nëpërmjet matësve, si dhe rritja e vjeljes së detyrimeve të grupit më të rëndësishëm të përdoruesve, pra të konsumatorëve privatë.

Studime të ndryshme kanë theksuar rëndësinë e veçantë që ka përmirësimi i kapaciteteve rajonale të transmetimit të energjisë elektrike. Kjo vlen në mënyrë të veçantë për periudhën kritike të dimrit. Përveç kësaj një përfshirje efiçente e Shqipërisë në rrjetin e transmetimit të Europës Juglindore ndihmon krijimin e një tregu rajonal të energjisë elektrike.

Studimet për realizimin me kosto të ulët të furnizimit me energji elektrike i japin një vend të veçantë përfshirjes së Shqipërisë në rrjetin rajonal të transmetimit të energjisë elektrike në nivelin 400 kw. Për momentin po shqyrtohen disa opsione për një përfshirje efçente. Nga një këndvështrim tekniko-ekonomik duket se lidhja e nënstacionit të Tiranës nëpërmjet një linje ajrore 400 kw nëpërmjet Vaut të Dejës me Podgoricën është opsioni më i mirë. Për të siguruar lidhjen e rrjetit shqiptar me atë të Kosovës është parashikuar që segmenti Tiranë-Vau i Dejës të shtrihet teknikisht në atë mënyrë, që të mundësohet me kosto të ulët një degëzim nga Vau i Dejës për në Kosovë. Sipas palës gjermane projekti mund të shqyrtohet brenda një kohe të shkurtër.

Pala shqiptare theksoi se ndërtimi i linjës Shqipëri-Mali i Zi ka prioritet të lartë për të, pasi është e rëndësishme për krejt rajonin. Meqë transmetimi i energjisë elektrike duhet të menaxhohet në mënyrë ekonomike, pala gjermane do të shqyrtojë mundësinë e dhënies së një kredie të përzier financimi të lirë (mjete financiare nga fondi i bashkëpunimit financiar dhe mjete financiare të KfW-së).

Duke pasur parasysh paqartësinë aktuale të financimit të ndërtimit të linjës në territorin e Malit të Zi (me koston totale të parashikuar afërsisht në shumën prej 7.3 milionë euro), pala shqiptare do të shqyrtojë nëse financimi i komplet linjës 400 kw nga Tirana në Podgoricë mund të kryhet nëpërmjet saj. Kusht për një iniciativë të tillë ndërkufitare do të ishte që konditat e këtij bashkëpunimi, ndërmjet Qeverisë shqiptare dhe Malit të Zi, do të mund të sqaroheshin shpejt dhe në mënyrë të kënaqshme për të dyja palët.

Pala gjermane deklaroi gatishmërinë e saj në rast të interesit parimor të të dy qeverive për këtë ecuri, të mbështesë masat plotësuese përgatitore të nevojshme (formulimin e marrëveshjeve ndërmjet KESH dhe EPCG) nga fondi i Europës Juglindore për studime dhe ekspertë.

Pala shqiptare deklaroi se pranimi i një financimi miks do të bëhet në përputhje me marrëveshjet që Republika e Shqipërisë ka me institucionet financiare ndërkombëtare për kredimarrjen.

Furnizimi me energji elektrike në jug të Shqipërisë

Nevoja për financimin e këtij projekti është më e lartë nga ç'ishte parashikuar në fillim. Për këtë arsye me mjetet financiare në dispozicion deri tani mund të mbulohej vetëm një pjesë e projektit. Për rehabilitimin e pjesës së mbetur (kryesisht hidrocentrali Bistrica II), do të nevojiten investime shtesë me një shumë prej afro 9,5 milionë euro. Të dyja palët ranë dakord të vlerësojnë financimin e këtyre investimeve me një kredi mikse, mjete financiare të tregut (p.sh. financim i përzier i lirë 15 % nga bashkëpunimi financiar + 85% mjete financiare të KfW-së). Pala shqiptare deklaroi se pranimi i një financimi miks do të bëhet në përputhje me marrëveshjet që Republika e Shqipërisë ka me institucionet financiare ndërkombëtare për kredimarrjen.

1.1.4 Reforma ekonomike/ndërtimi i ekonomisë së tregut

Të dyja palët u shprehën të kënaqura lidhur me bashkëpunimin pozitiv në sektorin e financës për mbështetjen e biznesit të vogël e të mesëm. Mjetet financiare të programit për mbështetjen e këtij biznesi aktualisht po vihen në dispozicion nëpërmjet Pro Credit Bank.

Të dyja palët ranë dakord që mjetet financiare në shumën prej 2,81 milionë euro, që janë tashmë gati për financimin e biznesit të vogël në zonat rurale dhe urbane, të shpërndahen nëpërmjet fondacionit FEFAD, sipas procedurave të zgjedhura në të kaluarën. Shteti shqiptar pranoi që t'ia kalojë mjetet financiare fondacionit FEFAD me kushtet e transferimit. Nga ana e vet fondacioni FEFAD do të lidhë Kontrata huadhënieje me institucione të kualifikuara.

1.1.5 Projekte të tjera

Sistemi i menaxhimit të mbetjeve Korçë/Pogradec (më parë për juglindjen e Shqipërisë).

Të dyja palët tërhoqën vëmendjen, lidhur me rëndësinë e përpjekjeve më të mëdha për përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve, sikurse u diskutua edhe me rastin e vizitës së Sekretarit të Shtetit z. Stather. Në këtë kuadër menaxhimi i mbetjeve në Korçë e Pogradec, si projekt pilot merr një rëndësi të veçantë.

Për fillimin e fazës së dytë të studimit të fizibilitetit për këtë projekt nevojitet miratimi në nivel kombëtar (Këshilli Kombëtar i Rregullimit të Territorit) i terrenit të zgjedhur për fushën e mbetjeve. Ndërkohë nga bashkia e Maliqit dhe qarku i Korçës është miratuar si vend i tillë Maliqi. Pala gjermane tërhoqi vëmendjen, lidhur me një miratim të menjëhershëm të këtij terreni në nivel

kombëtar, pasi në rast të kundërt do të shkaktoheshin vonesa në fillimin e fazës së dytë të studimit, parashikuar në mes të muajit nëntor 2003

1.2 Projekte të reja

Të dyja palët ranë dakord që me mjete nga bashkëpunimi financiar për vitin 2003 me një shumë prej 13,0 milionë euro të marrin në konsideratë realizimin e projekteve të mëposhtme:

1.2.1 Kanalizimet e ujërave të zeza Kavajë (vazhdim)	5,5 milionë euro
1.2.2 Kanalizimet e ujërave të zeza Korçë (vazhdim)	5,0 milionë euro
1.2.3 Planifikimi familjar (shtesë) financimi)	1,0 milionë euro (kontribute)

1.2.4 Furnizimi me energji elektrike në jug të Shqipërisë

(Bistrica II, financim i përzier, vazhdim) 1,5 milionë euro (hua)

Huaja jepet për një periudhë 40-vjeçare, me një përqindje interesi prej 0,75%.

p.a.(pro anno). Shlyerja e huasë filloi pas 10 vjetësh.

Për të plotësuar instrumentet e deritanishme të financimit, KfW-ja për llogari të vet mund të vërë në dispozicion kredi financuese për mbështetjen e projekteve të rëndësishme për politikën e zhvillimit për institucione apo biznese shtetërore apo private. Në qendër ndodhen si projekte të infrastrukturës sociale dhe ekonomike, ashtu dhe mbështetja e sektorit financiar. Në këtë kuadër KfW-ja vepron e ngarkuar posaçërisht nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë.

Për shkak të karakterit të projekteve që do të financohen, Shqipëria njeh rëndësinë për vënien në dispozicion në kohën dhe shumën e duhur të valutës së këmbyeshme për plotësimin e pakufizuar të borxhit (transferimi i valutës) përkundrejt KfW-së dhe përpiqet ta përmbushë këtë kërkesë duke respektuar afatet. Në këtë kuadër Shqipëria siguron të mos e vërë KfW-në në një pozicion më të disfavorshëm, krahasuar me institucione financuese shumëpalëshe.

1.3 Bashkëpunimi i ardhshëm

Në kuadër të sektorëve kyç të bashkëpunimit u ra dakord që ky i fundit të vazhdojë për këto projekte:

- Efienca e energjisë dhe mbështetja e energjive të rinovueshme;
- Sektori i financës - mikrosigurimet/mikrofinancimet;
- Menaxhimi i mbetjeve Korçë/Pogradec;
- Programi i financimit në sektorin e ujit;
- Kanalizimet e ujërave të zeza Vlorë;
- Furnizimi me ujë të pijshëm dhe kanalizimet e ujërave të zeza Ballsh, Përmet, Tepelenë;
- Mbrojtja e mjedisit, liqeni i Ohrit (WV/AE Pogradec) (shtesë financuese).

Këto projekte duhet të përgatiten nëpërmjet ekspertëve dhe/ose nëpërmjet studimeve të fizibilitetit.

2. Bashkëpunimi teknik

Të dy delegacionet ranë dakord që mjetet financiare të bashkëpunimit teknik t'i përdorin kryesisht për projekte, që synojnë afrimin e Shqipërisë me Bashkimin Europian, kryesisht në sektorin e reformës ekonomike/ndërtimit të ekonomisë së tregut. Nëpërmjet tyre synohet përmirësimi i kushteve të jetesës, veçanërisht për popullsinë e varfër. Krahas përmirësimeve të kushteve bazë ekonomike bashkëpunimi teknik dypalësh mbështet projekte në zona me struktura të dobëta, me qëllim që të përmirësohen mundësitë e njerëzve, që jetojnë në këto zona. Zonat më prioritare janë rajonet veriore të Shqipërisë dhe rajoni rreth Korçës e Pogradecit.

2.1 Bashkëpunimi teknik në vazhdim

Të dyja palët u shprehën të kënaqura me zbatimin e deritanishëm të projekteve aktuale në vazhdim. Në veçanti u diskutuan pikat e mëposhtme:

2.1.1 Modernizimi i ekonomisë bujqësore në Shqipëri

Të dyja palët bashkëpunojnë në mirëbesim të plotë për këtë projekt. Në kuadër të një dialogu intensiv profesional po punohet lidhur me tema të rëndësishme për afrimin me Bashkimin Europian, duke përmirësuar njëkohësisht bazat, që në të ardhmen prodhimet bujqësore shqiptare të mund të tregtohen më shumë në tregun europian. Një element i rëndësishëm në këtë kuadër është përmirësimi i cilësisë. Faza aktuale përfundon në vitin 2004 dhe për vazhdimin e saj të mëtejshëm për një periudhë dyvjeçare nevojiten mjete të reja financiare. Së shpejti projekti do të vlerësohet nga

një grup ekspertësh gjermanë e shqiptarë.

2.1.2 Hartimi i një plani urbanistik për qendrën e Tiranës

Të dyja palët shprehën kënaqësinë e tyre lidhur me përfundimin me sukses të konkursit urbanistik për qendrën e Tiranës. Në dispozicion kanë mbetur dhe rreth 100 000 euro. Në rast se këto fonde nuk do të përdoren për një projekt tjetër të Bashkisë së Tiranës, pala shqiptare deklaroi se fondet mund të përdoren në kuadër të fondit të studimeve e të ekspertëve për projekte të tjera. Pala shqiptare ka ndërmend që së shpejti të bëjë propozime konkrete përkatëse.

2.1.3 Këshillimi ligjor i Bankës së Shqipërisë

Faza e parë e projektit përfundon më 31.12.2003. Ky projekt e ka ndihmuar Bankën e Shqipërisë në çështje të ndryshme ligjore, duke kontribuar në një "kuptim më të mirë të çështjeve të bankave qendrore europiane, si dhe të monedhës europiane. Gjatë konsultimeve të vitit 2003 pala shqiptare shprehu dëshirën për këshillim lidhur me përafrimin me sistemin monetar europian. Në këtë kuadër pati para pak kohësh një mision ekspertësh, që saktësoi më tej pikat konkrete të nevojës për këshillim. Ky lloj bashkëpunimi do të financohet me mjete nga fondi për studime dhe ekspertë.

2.1.4 Fondi i studimeve dhe i ekspertëve (i vjetër)

Fondi (me një shumë prej rreth 2,3 milionë euro) përfshin 14 masa të veçanta. Janë në dispozicion edhe rreth 190 000 euro, që mund të përdoren për ndonjë masë të vogël.

2.1.5 Fondi i studimeve dhe i ekspertëve 2002

Fondi ka mjete financiare të pambuluara në shumën rreth 390 000 euro.

2.2 Premtime të reja

Shuma e përgjithshme e bashkëpunimit teknik të deritanishëm me Republikën e Shqipërisë kap shifrën 35,5 milionë euro. Për vitin 2003 Republika Federale e Gjermanisë i akordon Republikës së Shqipërisë, një subvencion tjetër për zbatimin e projekteve të bashkëpunimit teknik në shifrën 3.0 milionë euro.

2.3 Përdorimi i mjeteve financiare

Të dy delegacionet janë të mendimit që të përdoret shuma (pika 2.2) për projektet e mëposhtme:

2.3.1 Fuqizimi i ekonomisë në rajonin Korçë/Pogradec dhe në veri të Shqipërisë nëpërmjet kualifikimit profesional 100 milionë euro

2.3.2 Modernizimi i ekonomisë bujqësore e ushqimore dhe përafrimi i saj me Bashkimin European (shtesë) 0,75 milionë euro

2.3.3 Fondi i studimeve dhe i ekspertëve 2003 1,25 milionë euro

Të dy delegacionet ranë dakord të mbështesin me mjete financiare nga fondi i studimeve dhe ekspertëve masat e mëposhtme:

- Këshillim për zhvillimin e tregut të kapitalit (trajnim i punonjësve të bursës, dialog rajonal);

- Këshillim për zhvillimin e profesionit të auditit, ekspertëve të kontabilitetit;

- Mbështetje për kualifikimin e gjykatësve dhe avokatëve në fushën e së drejtës së falimentimit;

- Këshillim për përafrimin e Bankës së Shqipërisë si bankë qendrore, me sistemin e bankave qendrore europiane;

- Shkëmbim profesional i menaxherëve shqiptarë me ekonominë gjermane dhe forcimi i shoqatave shqiptare të biznesmenëve, faza e dytë;

- Mbështetja e bashkëpunimit teknik dypalësh;

- Mbështetje për zyrën-*antidumping* pranë Ministrisë së Ekonomisë;

2.4 Bashkëpunimi i ardhshëm

Të dy delegacionet ranë dakord të marrin në konsideratë fushat e mëposhtme për këshillin e asistencës në kuadër të bashkëpunimit teknik në të ardhmen:

- Mbështetja komunale e bizneseve në qytete të përzgjedhura (projekt i ri);

- Mbështetja rajonale për ekonominë dhe punësimin në rrethe me strukturë të dobët të zonave veriore të Shqipërisë, faza e dytë;

- Masa për pakësimin e varfërisë për persona me aftësi të kufizuar nëpërmjet integritit të tyre në ekonomi e shoqëri (projekt i ri);

- Forcimi i mbrojtjes së konsumatorit;
- Verifikimi i mundësisë së mbështetjes për Agjencinë e Nxitjes së Investimeve të Huaja, Agjencinë e Nxitjes së Eksporteve, Agjencinë e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme;
- Shtim i fondit të studimeve e të ekspertëve;
- Euregio liqeni i Prespës - zhvillim rajonal ndërkufitar: pjesa shqiptare e këtij bashkëpunimi për fazën e dytë;
- Verifikimi i mundësisë së mbështetjes për ngritjen e një infrastrukture metrologjike shqiptare;
- Verifikimi i mundësisë së mbështetjes së Drejtorisë së Gjeologjisë të Shqipërisë.

3. Forma të tjera të bashkëpunimit teknik

3.1. Ekspertë të integruar

Delegacioni gjerman theksoi se Republika Federale është e gatshme të ndihmojë Shqipërinë për të mbuluar nevojat për ekspertë në fusha me rëndësi për zhvillimin e vendit, të tilla ku mungojnë ekspertë vendas. Në këtë kuadër qeveria federale mund të asistojë për gjetjen e ekspertëve të përshtatshëm në tregun gjerman të punës dhe të sigurojë financimin e tyre, brenda mundësive të veta financiare.

Aktualisht ndodhen në Shqipëri dy ekspertë të integruar, që punojnë në fushën e formimit profesional dhe në atë të bujqësisë. Ndërmjetësimi për gjetjen e ekspertëve në të ardhmen do të përqëndrohet kryesisht në pikat kyçe të vendosura nga të dy qeveritë.

Kërkesat për ekspertë të integruar mund t'i paraqiten "Qendrës për migrim ndërkombëtar e zhvillim (CIM)" Barckhausstr. 16, D-60325 Frankfurt/M, nëpërmjet ambasadës gjermane. Kërkesat mund të paraqiten nga struktura publike apo private shqiptare.

3.2 Veprimtaria e fondacioneve politike gjermane

Delegacioni gjerman vuri në dukje se aktualisht fondacioni Fridrich-Ebert, ai Konrad-Adenauer dhe Hanns-Seidel vazhdojnë të veprojnë në Shqipëri, të mbështetur financiarisht nga qeveria federale. Përveç kësaj Instituti për Bashkëpunim Ndërkombëtar i Shoqatës së Shkollave të Larta të Gjermanisë realizon masa mbështetëse për arsimimin e të rriturve.

3.3 Puna e qendrave kishtare

Kryesuesi i delegacionit gjerman informoi se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë mbështet financiarisht dhe bashkëpunimin për zhvillim të institucioneve kishtare gjermane në Shqipëri.

3.4 Shërbim këshillues i Senior-Experten-Service (SES)

Pala gjermane informoi lidhur me veprimtarinë e SES-së të mbështetur nga qeveria federale. Pikë kyçe e këshillimit nëpërmjet ekspertëve në pension, ndërkohë, është eliminimi i problemeve teknike dhe/ose ekonomike të bizneseve të vogla e të mesme.

4. Kushtet për zbatimin e projekteve

Të dy delegacionet janë të mendimit se të gjitha shërbimet e parashikuara në këtë protokoll (në pikat 1 dhe 2) mund të realizohen nga pala gjermane vetëm pasi:

- Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë të ketë marrë një vendim pozitiv pas shqyrtimit të projekteve/programëve nëpërmjet Bankës për Rindërtim (KfW) dhe Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Teknik (GTZ) dhe/ose një organizmi tjetër të ngarkuar me zbatimin e projekteve;

- të jetë siguruar financimi i plotë i projektit/programit;
- të kenë hyrë në fuqi marrëveshjet ndërkombëtare ende të palidhura (marrëveshje qeveritare dhe marrëveshjet për projekte), kontratat e financimit apo kredihënies, si dhe marrëveshjet e zbatimit me KfW-në, GTZ-në dhe të tjera organizma zbatuese, nëse ka të tilla.

5. Kufizim

Pala gjermane tërheq vëmendjen, në mënyrë të veçantë, lidhur me faktin se projektet për bashkëpunim financiar (pika 1) dhe të bashkëpunimit teknik (pika 2) shfuqizohen pa zëvendësim, nëse 8 vjet pas vitit të miratimit të projektit nuk janë përfunduar marrëveshjet për zbatim, d.m.th. kontratat e financimit/huadhënies në rastin e bashkëpunimit financiar dhe shkëmbimi i notave në rastin e bashkëpunimit teknik. Për projektet e vitit 2003 ky afat përfundon më 31.12.2011.

Nëse një ose disa prej projekteve të përmendura nuk zbatohen apo zbatohen pjesërisht, atëherë ai/ato mund të zëvendësohen me një apo disa projekte të tjera në marrëveshje ndërmjet të dyja palëve.

6. Deklaratë

Pala gjermane përshëndeti masat e marra nga Qeveria shqiptare për luftën kundër korrupsionit. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë shprehin të njëjtin vlerësim se korrupsioni dëmton qeverisjen e mirë, shpërdoron mjetet financiare dhe ka efekte të gjera negative si në zhvillimet ekonomike, dhe në ato sociale. Ai rrezikon besueshmërinë e bashkëpunimit për zhvillim, mbështetjen e tij nga opinioni publik dhe dëmton përpjekjet e të gjithë atyre që punojnë për mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm. Korrupsioni pengon konkurrencën e hapur dhe transparente, ndër të tjera edhe konkurrencën që synon çmim e cilësi.

Të dyja qeveritë do të punojnë ngushtë me njëra-tjetrën për të garantuar transparencë, llogaridhënie dhe integritet për përdorimin e mjeteve publike, financiare dhe për të shmangur mundësitë për veprime të korruptuara në bashkëpunimin e tyre për zhvillim.

Të dyja delegacionet ranë dakord që konsultimet dhe bisedimet e ardhshme qeveritare të zhvillohen në Tiranë në vitin 2004. Afatet do të përcaktohen më vonë.

Ky protokoll është hartuar në gjuhën shqipe dhe atë gjermane.

Ky protokoll hyn në fuqi pasi pala shqiptare të vërë në dijeni palën gjermane me anë të një note verbale, lidhur me përfundimin e procedurave ligjore për miratimin e tij.

Tiranë, 25 nëntor 2003

Për delegacionin e Qeverisë së Republikës
Federale të Gjermanisë

Z. Dr. Leo Kreuz

Për delegacionin e Qeverisë së Republikës të
Shqipërisë

Z. Luan Shahollari

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI JANAR 2004

1.	KUSHTETUTA	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	KODI DOGANOR (DISPOZITA ZBATUESE)	1500
11.	KODI RRUGOR (DISPOZITA ZBATUESE)	1500
12.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
13.	PËRMBLEDHËSE NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
14.	PËRMBLEDHËSE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
15.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

BOTIME TË REJA

Së shpejti në botim, përmbledhje në fushën e taksave dhe tatimeve

Doli nga shtypi më 26.1.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2004

Çmimi: 150 lekë